

A General Survey on *Vepra Pijore* (1907-1946)

Abstrakt: *Vepra Pijore* was an association of the Catholic Clergy, founded in the Saverian Seminary in Shkodra in 1907. The association was created to serve the propose of publishing and distributing useful works such as calendars, novels, history books, hagiography studies, translation of books on religion etc. Standing for Pious Works, the *Vepra Pijore* formed part of the Albanian National Awakening as it contributed to the national question, to the enriching and purification of the language from Ottoman loans. It also lay the groundwork to the literary Albanian by continually ameliorating phonetics and graphemes used in its publications in time.

The main supporter of the *Vepra Pijore* was the printing press “*Zoja e Papërlyeme*”, in Shkodra.

The foundation of the *Vepra Pijore* was the result of the ceaseless efforts of a group of clergymen who managed to publish a collection of 44 works spanning difficult years in Albanian history. Fr. Shtjefën Zadrima, S.I., creator of such project along with Fr. Francesco Genovizzi, S.I., its founder and several other co-operators and benefactors made possible the publication of such collection, which contributed to Albanian literature, history, archaeology and religion.

Keywords: *Vepra Pijore*, Jesuit Fathers, periodicals, Shkodra, Albanian literature.

Hyrje

Vepra Pijore, emër të cilin e mori në nderim të Papa Piu-t X, ishte një shoqatë e klerit katolik e themeluar në Kolegjin Saveriane të etërve jezuitë në Shkodër në vitin 1907¹, sipas modelit të *shoqërive pijore* gjermane apo austriake². Për punën e këtij kolegji dhe të etërve jezuitë, vetë Faik Konica, ish-student i Kolegjit Saverian ka thënë se: “...mahet me një shkallë të natle,

1 “Shoqërat Gjithsore të Rilindjes; XXX vjetori i “Vepres Pijore”, LEKA, 1937, n. 5, f. 233-235.

2 M. Peters, *Shtëpia botuese më e vjetër e Shqipërisë dhe kontributi i saj për Lëvizjen Kombëtare, arsimimin dhe kulturën*, Qendra Botuese Shoqata e Jezuitëve, Tiranë 2016, f. 305.

e githë ata që kanë përshkolluar e Frances e t' Evropës munnen me deshmue se ajo e Shkodrës asht e zonja për shume pune, me u vù me një me to... Pra, le t'ia dimë te mirat që i bani Shqypnjes [...] e na duket detyrë me i a u dit ma teper Baballareve Jesuitë”³. Ky vlerësim tërë kjo punë e mirë e saj e bëri këtë kolegje, të lëshonte dëftesa ekuivalente me ato austriake e italiane⁴.

Shoqata, siç shkruante Atë Frano Gjenovici S.J., “kë themelue n'prëhen t'Kongregacionit t'Zojës Nuncjatë”⁵ dhe qëllimi i saj ishte të botojë libra “t'kândshem e t'dobiishem”, “libra apo librecë literatyre, kallxime historije të kishës apo të shekullit, libra historije të natyrshme, romanza moralishte, libra apologji, përkthime të Ungjillit, jetë shenjtërish e gjëra të tilla që të jenë në nevojë të vendit”. Natyra e këtyre shkrimeve është aq e gjerë sa ata theksojnë se: “Shkrimet që dona me qitë t'jeen asi sojit, që mund t'i blejnë e t'i kndojn edhe ç'do misliman a ortodoks i cilli mos t'jeet fanatik për besim t'vet”⁶, për të theksuar natyrën e tyre në dobi të vendit, arsimit dhe zhvillimit të tij përmes dijes, librave, dokumenteve historike etj. Qëllimi parësor i kësaj shoqërie, ishte krijimi i një *Vepre* me baza të shëndosha morale.

Kjo *Vepër* u bë termometri historik i ngjarjeve të asaj periudhe plot ngatërresa e vështirësi për vendin tonë. Botimet e përkthyer të *Veprës Pijore*, përcillnin modelet e problematikave të shoqërisë së kohës dhe qëmtonin t'i jepnin rëndësi shkollimit, fuqizimit të familjes, organizimit të njeriut brenda normave dhe rregullave, për t'u afruar me vende të tjera të zhvilluara. Kjo shoqatë përmes punës së saj, me meritën e Kishës Katolike, të Kongregacionit dhe tipografisë “Zoja e Papërlyme”, i paraprinë lëvizjes për pavarësi, për përhapjen e fesë dhe për ruajtjen, shkrimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës shqipe. Gjithë kjo përpjekje duhet të vlerësohet për ato kohë që po kalonte vendi.

Viti i krijimit të saj, i paraprin lëvizjeve të rëndësishme në historinë tonë, por edhe vjen si vazhde e lëvizjes së Rilindjes për një kontribut të qëndrueshëm në çështjen kombëtare, në pastrimin, zhvillimin e pasurimin e gjuhës shqipe, në hedhjen e bazave të shkrimit të shqipes letrare duke bërë saktësime të vazhdueshme fonetike e grafike të këtij organi ndër vite. Etërit dhe shkrimtarët e kësaj shoqërie jezuite kanë dhënë kontribute të rëndësishme pedagogjike e letrare për lëvizjen e Rilindjes⁷. Nevoja për hulumtim mbi punën e kësaj shoqërie lidhet jo vetëm me rëndësinë e

3 F. Konica, “Kleri i huaj edhe jesuitët në Shqipëri”, Albania, 1900, Viti IV, n. 3, f. 78.

4 Kolegia saveriane në një dokument të lëshuar më 30 qershor 1917 nga Ministria perandorake dhe mbretërore vjeneze e Kultures dhe nga Ministria e Jashtme njofton se dëftesat e gjimnazit të Shkodrës janë për t'u vlerësuar si ekuivalente me ato austriaket dhe në vitin 1924 edhe me ato italiane. Shih: M. Peters, vep. cit., f. 56.

5 *Kalendari Vietar* 1915, f. 48.

6 Po aty, f. 48.

7 M. Peters, vep. cit., f. 63.

publikimeve, monografive etj., por dhe mbështetjen që jezuitët i dhanë në atë kohë të vështirë politike, gjuhës dhe letërsisë sonë kombëtare.⁸

Një ndër ngjarjet e shënuara për atë kohë dhe për krijimin e *Veprës Pijore*, është hapja e “Tipografisë së Zojës së Papërlyeme” në Shkodër (shtëpisë botuese “Zoja e Papërlyeme” iu dha leja zyrtare në 1869⁹) e cila u vu në funksion në vitin 1870¹⁰. Bëhet fjalë për një shtypshkronjë që i kalon përmasat dhe funksionet si e tillë.¹¹ Nga fillimi i krijimit të saj (1869/70) deri në mbyllje (1944/45), kjo shtypshkronjë ka ndryshuar disa herë emrin e saj. Në shek. XIX ajo quhej “sctamp i kolegs” (si një shtypshkronjë tërësisht private e Seminarit Papnor) e disa kohë më vonë, nga viti 1909, jezuitët i shtuan shtypshkronjës emrin “Zoja e Paperlyeme”¹², një emër i paunifikuar për disa vite me radhë. Disa forma të tij janë: *Shtypshkroja e Zojës Papërlyeme* (kalendari i 1912-s), *Shtypshkroja e së Paperlyemes* (kalendari i 1913-s), *Shtyp. e Zojës Paperlyeme* (kalendari i 1914-s), apo edhe *Shtypshkroja e Zojës s’Paperlyeme* (kalendari i 1916-ës) etj.¹³

Si “shtëpia më e vjetër botuese” e mban vendin e nderit në dy pikëpamje: nga njëra anë në lidhje me datën e themelimit të saj, nga ana tjetër në lidhje me jetëgjatësinë e saj.¹⁴ Edhe nëse flasim për shtypshkronjën e Voskopojës të themeluar më herët (1720-1730) aty janë botuar rreth 20 libra fetarë në gjuhën greke, ndërsa shtypshkronja e jezuitëve, vuri themelet e botimit të librit në gjuhën shqipe në truallin shqiptar.¹⁵ Aty u botuan tekste shqiptare brenda mëmëdheut të shqiptarëve¹⁶ vite më përpara se botimet më të njohura të Rilindjes. Kjo tipografi numëron mbi 730 botime me një numër faqesh që i kalon 65000, ku nga viti 1909 bëjnë pjesë edhe botimet e *Veprës Pijore*¹⁷.

Shtypshkronjat e para ishin dyert nismëtare drejt dijes në atë kohë të nderë që kalonte vendi ynë. Aty gjejmë sot lidhjen me emrat më të mëdhenj të historigrafisë dhe gjuhës shqipe.

Në vitin 1891 filloi botimi i së përkohshmes mujore fetare nën titullin “Elcija e Zemers s’Jezu Krishtit” nga Kolegji i Jezuitëve Shkodër,¹⁸. Kjo revistë

8 Po aty, f. 13.

9 Po aty, f. 11

10 Po aty, f. 77.

11 Po aty, f. 18.

12 Po aty, f. 18.

13 M. Peters, vep. cit., f. 100-106.

14 Po aty, f. 11

15 Po aty, f. 77.

16 Po aty, f. 11.

17 Po aty, f. 93.

18 Nga viti 1914 deri në vitin 1944 vazhdoi me emrin *Lajmtari i Zemres s’Jezu Krishtit*.

(1891-1913), dhe drejtuesit e saj me kontributin e tyre të vyer u bënë shkas për të krijuar e për t'i dhënë jetë *Veprës Pijore* dhe punës së saj¹⁹.

Në vjeshtë të vitit 1897, Mit'hat Frashëri botoi numrin e parë të periodikut vjetor "Ditërrëfenjës" [Ditepëfës], që do të quhej më vonë "Kalendari Kombiar". Ky kalendar i shkruar në shqip, me dashuri të madhe për vendin e për gjuhën shqipe, synonte të bashkonte shqiptarët me njëri-tjetrin, drejtuar çdo mëmëdhetari.²⁰

Në vazhden e kalendarëve, mund të numërohen disa:

"Kalendar SCCYP", 1898, kalendar i dytë i plotë i Jezuitëve²¹ në Shkodër i festave fetare të tri besimeve fetare, me kronika e data e ngjarje të ndryshme historike, i shtypur në alfabetin gegë të shqipes së vjetër.²²

"Kalendari i Maleve", 1900 nisur si botim i përvitshëm në Bruksel nga Faik Konica, i cili përmbante festat fetare, lëndë kulturore, kronika, këshilla bujqësore, etj., në gjuhën shqip. Emrin e mori pikërisht nga lidhja e fortë që ka fjala Shqipëri me fjalën mal.²³

"Kalendari Afredita", botuar në Stamboll, në vitin 1909 me lëndë kulturore, enciklopedike, letrare, shoqërore etj.

Kalendar i *Korça*, botim i përvitshëm, përmban festat fetare ortodokse e lëndë të ndryshme kulturore, letrare, shoqërore, kronika të kohës etj. botuar më 1909-1931, në Korçë, Manastir, Kostancë. Po ashtu për dy vite, 1919-1920, dhe Kalendari Poradec (Pogradec), botuar në Korçë.

Kalendar i Vatrës, nga Fan Noli, botuar në Boston në 1918, përmban kalendarin e festave të besimeve fetare, data e kronika për historinë e Shqipërisë dhe Rilindjes Kombëtare.

Këto vite njihen për botime të vyera si: revista e parë e botuar jashtë vendit "Albania" në 1897 nga Faik Konica, gazeta "Tomorri" në vitin 1910 nga Lef Nosi, revista e klerit katolik "Hylli i Dritës", në 1913, themeluar nga Atë Gjergj Fishta, revista "Kopështi letrar" (1918-1919) botuar në Elbasan etj.

Vepra Pijore dhe figurat kryesore të këtij kontributi

*Vepra Pijore*²⁴ u krijua në vitet 1907/08, prej drejtorit të "Kongregacionit të Zojës Nuncjatë të Shkodrës, Atë Shtjefën M. Zadrima S. J. (1869-1916) dhe Atë Françesko Gjenovici (Francesco Genovizzi 1864-1937). Ideja e krijimit të *Veprës Pijore* ishte e Atë Shtjefen Zadrimës, "per të përhapun të shtypit të mirë shqiptar", por programin e saj e hartoi dhe e zhvilloi atë Gjenovici,

19 *Lajmëtari i Zemrës s'J. Krishtit*, mars 1916, f. 63.

20 *Kalendar shqip Ditërrëfenjësi*, viti I, 1897, f. 3.

21 I pari njihet "Miku Bestaar", 1889, shih: M. Peters, vep. cit., f. 350.

22 M. Peters, vep. cit., f. 353.

23 *Kalendar i maleve*, Bruksel, 1900, nr. 1, f. 8.

24 Rreth çështjes së emrit, shih: M. Peters, vep. cit., f. 305, 414.

me ndihmën e të cilit “idealet e kësaj Vepre do t’i çëmojnë lexuesat edhe më mirë tue studjue programin e saj”.²⁵ *Vepra Pijore* drejtohej nga një këshill i cili përbëhej nga pjesëtarë jo veç Kongreganistat e Zojës Nuncjatë por edhe tjetër kush e sidomos shokët e Rrethit Sh’Jozefit një pikë kjo e saktësuar në programin e *Veprës Pijore*. Ky këshill ndërrohej çdo vit: anëtarët e vjetër zgjidhnin 3 emna nder t’cillët Shokët ndimtarë në një mledhje mas një konferenzen mii *Veprës Pijore* zgjidhnin kryeparin e këshilltarët e tjerë dhe këta pastaj, me gjithë Direktorin zgjidhnin zyrtarët tjerë. Emrat e zgjedhur, munden me kenë edhe t’kshillit vjetër.

Puna e drejtuesve të saj ishte e madhe “me i vjeftun Fees dhe letratyres e giuhës”, me i “perkrahun gjytetnimit e perparimit t’popullit” e “vetun per hater t’Zotit e t’Shqypniis”, kanë punuar “Drejtorët e Bashkpuntorët e Lajmtarit, t’Perparimit, e t’Veprës Pijore”.²⁶ Puna e parisë së *Veprës Pijore*, vihet në dukje, pasi “n’mos t’ishin këne Paria e Vepres Pijore a e Kongregacionit t’trimave n’njën anë, e Pater Rektori i Kolegjes Papnore n’tjetren”²⁷, këto vepra, të cilat përpiqen për të mirë e për të vërtetë të vendit e përparim të gjuhës e letërsisë, nuk do të kishin pasur jetë.

Shoqërinë e *Veprës Pijore*, e mbanin në këmbë përgjatë atyre viteve Atë Shtjefën Zadrime, Atë Frano Gjenovici (Francesco Genovizzi), Gjon Çoba, Pjerin Simoni, Kolë Vogli me të vëllain Ndreken, e disa të tjerë si: Ndoc Çoba²⁸, Gjon Ashiku, Gjon Shiroka etj. Nevoja e kësaj vepre, sipas Atë Frano Gjenovicit (Francesco Genovizzi), diktohet nga mangësitë e mëdha të kohës, sepse: “një popull qi s’kaa letratyre, s’kaa as jetë as përparim”²⁹.

Fillimisht *Vepra* është drejtuar nga dy etërit: Atë Shtjefën Zadrime dhe Atë Frano Gjenovici (Francesco Genovizzi), e më pas nga ky i fundit, i vetëm, nga viti 1916-1925. Nga viti 1925-1928 e ka drejtuar Atë Mark Harapi e pas tij deri në vitet 1945/46 e drejtoi Atë Zef Saraçi.

Atë Shtjefën Zadrime, ideatori i *Veprës Pijore*, ka qenë nxënës i Kolegjit Saverian qysh në themelimin e tij e më pas mësues po aty. Drejtoi për disa vite *Veprën Pijore* deri në vitin 1916, kur u largua nga jeta prej një sëmundjeje të rëndë.

Atë Frano Gjenovici (Francesco Genovizzi) punoi pa u lodhur e dha një kontribut prej 49 vitesh në shërbim të Shqipërisë si një njeri me kulturë të lartë. Ishte një nga frymëzuesit e kulturës katolike shqiptare, sidomos vitet 1900-1920. Për shumë vite drejtues i revistave të “Elçijes” e më pas

25 Në artikullin “Shoqinat Giuhore të Rilindjes; XXX vjetori i “Veprës Pijore”, jepet programi i krijuar nga Atë Frano Gjenovici, me rastin e 30-vjetorit të “Veprës Pijore”, shih: LEKA, 1937, n. 5, f. 233.

26 *Lajmëtari i Zemres s’J. Krishtit*, mars 1916, f. 51.

27 Po aty, f. 55-56.

28 Në vitin 1914 është kryetar i shoqërisë, shih: *Kalendari Vietar* 1915, f. 49.

29 *Kalendari Vietar*, 1915, f. 51.

“Lajmëtarit”, u bë si të thuash “dekani i shtypit shqiptar”³⁰. Vlerësohet për vënien e gjuhës shqipe si gjuhë mësimi në shkollat e mesme. *Vepra Pijore* lulëzoi si vepër kulturore e si vepër bâmirëse³¹ në drejtimin e tij.

Atë Anton Maria Xanoni (1863-1915), bir i një emigranti shqiptar nga Dalmacia. Në nivelin akademik e kulturor renditej si një ndër intelektualët dhe letrarët më të shkëlqyer të kohës së tij³². Vetë Fishta, i kushton një poezi nxitjeje Atë Anton Xanonit³³ që të vijojë përkthimin e Eklogave të Virgjilit, pasi këto do të ishin dritare të mendjes e të shkrimit (“Jo; kurr n’ pun t’mbara t’mos lshoje zëmera,/ Pse ndihma t’fortit i vjen prej s’t’Eperit”). Emri i tij do shkruhet me shkronja të arta e prej humnerës së harrimit do të mbrohet. Këtë vlerësim për këtë figurë, Fishta e ka treguar edhe në poezinë kushtuar largimit të tij në amshim (“Mbi vorr t’A. Anton Xanonit S.J.”, 1915). Ndër vargje poeti vlerëson punën e tij prej atdhetari e gjuhëtari. Puna e vyer që ka bërë në të mirë të gjuhës shqipe që “e kishte rmue e njoftë marë³⁴”, duket në numrin e madh të veprave të lëna pas: 11 libra e 35 dorëshkrime.

Njeri i një rëndësie të veçantë për kontributin që ka dhënë me veprën e tij, vlerësohet Imzot Luigj Bumçi. Me rastin e 25 vjetorit të ipeshkvisë së tij, që përkon me 25 vjetorin e Pavarësisë, vlerësohet puna e tij ku “pasqyroi gjith frymen, veprimtarinë, vetëmohimin atdhetar të Katholoqizmsë Shqiptare e veçanisht të Klerit Katholik Shqiptar”.³⁵ Figura e këtij prelati “njifet jo vetem prej shqyphtarve, por edhe prej te huejve”.³⁶ Fjala e Imzot Bumçit në raste kritike për vendin tonë, u bë faktor kryesor për çështjen kombëtare.

Kolë Thaçi gjithashtu me përkthimet e tij dha një kontribut të vyer në kolanën e *Veprës Pijore*. Ai vlerësohet nga Koliqi se “me përpajnimin në stil poetik të shqipes të një syntaksi të ndërlikuem e naltësoi në shkallë më t’epër letrare poezin t’onë. Thaçi, sidomos, i çeli shtegun me styl poetik të vetin të zgjedhun e të përpunuem mundësisë së përkthimit të veprave të mëdhâ klasike (Homeri, Virgjili etj.). Si poet nuk la ëmën, si pjonjer i naltësimit të shqipes në mjet të aftë për çdo provë të lartë artistike duhet të zâjë një vend të shënueshëm”.³⁷

30 Në përkujtim të veprimtarisë së Atë Frano Genovizzit, në largimin e tij në amshim (28 prill 1937), shih: “Zi në famije të “Lekës”, *LEKA*, 1937, nr. 4, f. 185.

31 “Shoqninat Giûhsore të Rilindjes”, *LEKA*, 1937, n. 5, f. 233.

32 M. Peters, vep. cit., f. 550.

33 Botuar si dorëshkrim si një poezi kushtuar kontributit të Atë A. Xanonit në përkthim, shih: *Hylli i Dritës*, 1941, n. 3-5, f. 222-223.

34 “Jeta dhe veprimtaria e Atë Ndoc M. Xanoni”, *Perparimi*, 1915, n. 3, f. 41.

35 “Imzot Luigj Bumçi”, *LEKA*, 1937, n. 1, f. 31.

36 “Emzot L. Bumçi në 25 vjetorin e Ipeshkvis”, *Hylli i Dritës*, 1937, n. 2-3, f. 71.

37 E. Koliqi, “Dý shkollat letrare shkodrane”, *Shejzat*, 1973, n. 9-12, f. 373-379.

Disa emra që janë bërë pjesë e botimeve me shkrime apo përkthime, mund të përmendim: Pashko Gurakuqi, Gjon Ujka, Zef Harapi, Shtjefën Gjeçovi, Nikoll Kimza, Lazer Shantoja, Llesh Bitroj, Kolec Prennushi etj.

Vlerësimi për këto figura që dhanë kontributin e tyre, nuk ka munguar edhe në vazhdimësi. Kjo shoqatë, bashkë me shumë revista e fletore të kohës, u bënë mbështetëset kryesore të krijimit të një shkolle letrare. Ernest Koliqi thotë: “Si dihet zhvillimi i letërsisë s’onë reflekse, nga rrethënat historike të kombit t’onë, u bâ copa copa dhe në vise e mote të ndryshme. Lulzuen vepra ndër Arbreshë t’Italis, në shoqnit e Stambollit, të Bukureshtit, të Misirit, ndër Vatrane të Shteteve të Bashkueme t’Amerikës; mueren hov gjatë motive rrymba kulturore e letrare në disa krahina të Shqipërisë (Shif Shkrimtarët e vjetër të Veriut, Shkrimtarët e vjetër të Jugut, Shkrimtarët e vjetër myslimanë dhe në kohë më të vona qandrat letrare t’Elbasanit, të Korçës, të Shkodrës etj.)”³⁸ Kështu kemi një përmbledhje të rrugës së shqipes dhe letërsisë së saj në këto vite. Bukuria e rrjedhshmëria e gjuhës së përdorur nga ata autorë shijohej si gjuhë që “të depërtonte trûnin e shiset me një âme të hollë jete shqiptare”, dhe këto shkrime të sjellin “âmsimet e vendit të lindjes” “një plasje hareje në shpirt” e me një mori shprehjesh të pastra e të thjeshta “me sa begatë thânjesh idiomatike, ku vlon undyra e mystershëme e ligjirimit arbnuer”³⁹.

Nga Atë Frano Gjenovici kemi Programin e *Veprës*⁴⁰, tekstualisht si vazhdon:

1. *Âsht teper e vertet qi na Shqyptarët kena nevojë per një leteratyrë t’shndosht’ e mâ të plotshme. E praa:*
 - (1) *Tuj paa se janë teper pa kata qi punojn me e krijumun.*
 - (2) *Tuj njoftë se n’dit t’ona Shqyptarët kahë fillojn me shkundë gjumin e paddies, doon me kndue libra e tuj vûu oroe se sidomos masa e ree i hinë me cenë kti shtegut me gjith eshtah të zëmërs.*
 - (3) *Tuj marrë me mënd qi n’mos paçim libra të mirë, populli e sidomos masa e reek an m’u lshue mas librave të kqii; kena daa qysh n’v. 1907 me pelqim t’lpeshkvive e t’Argjipeshkvive të Shqypniis mas pasqyret të Piusverein t’Gjermanies, me temelue një veper qi saa ku t’na mrriin fuqija t’u bajn ballë ktyne nevojve e sikur ajo e kaa êmnin prej t’madhit Pio IX nen t’cillin kje nisë, njashtu e jona prej Pio X do t’quhet Veper Pijore.*
2. *Filli i vepers âsht me botue krye vjetit do libra ndo librecâ literatyrret, kallxime historiake t’kishes a të shekullit, libra historijet t’natyrshme, romanza moralishte, libra apologjijet, perkthimin e Unjillit, Jeta Shêjtnish e kso nduershm qi t’jeen mas nevojve qi diftueme në pikë t’paar.*
3. *Per zhvillim e per lulzim t’ksaj Veper aq të frytshme e kaq të nevojshme*

38 Po aty, f. 377.

39 Po aty, f. 373.

40 “Shoqninat Giûhsore të Rilindjes”, *LEKA*, 1937, n. 5, f. 233-235.

per vend t'onë do të ndihmojn dy soj njerzish; pse një paal mund t'ndimojn me punë e tjerët me të holla. – Shkrimtaar i ksaj veper mundet me kenë kushdo qi tuj kenë nieri i ndershem e i njerzishem n'jetë t'vet, t'jeen i zoti edhe me perdorue kalemin; e praa jo veç ç'do prift a regulltaar, por edhe ç'do shekullaar.

4. Tierët qi t'ndimojn vetun me t'holla, doon thirrë – Ndimtaar t'tretës a t'dytes a t'pares klasë: E treta klasë do t'napin sadopak 1 Koron n'vjetë, e dyta 5 Koron e e para 1 napoljon a një lirë Turkut. – Kush t'falin maa shum kaa m'u queitun Shok temelues; e tjerët Shok Ndimtaar.
5. Vepra Pijore kaa per t'pasë një pajtuer b.f. argjipeshkvi i Shkoders kaa m'u thirrë Kryepaar nderimit i Vepers, e qi kaa m'u lutun me marrë pjesë n'festë t'pergjithshme qi Vepra do të bâjn një herë n'vjetë per m'u marr vesht me Shok e me i dhanë shkasë t'rii punimit t'vetë.
6. Kaa lee e â rritë Vepra Pijore n'prehen të Kongregacionit t'Zojës Nuncjatë. E prashtû Kshilli i sajë një herë n'vjet kaa per t'i dhanë arsye Pariis të Kongregacionit per hesape e per veprim të vet t'deriat-herëshem e t'ardhshem.
7. Kshilli i Vepres Pijore â i perbâmun prej një Jezuiti e prej disaa vetve tjerë. – Nen drejtim t'atii kaa m'u zgjedhë e kaa me i kqyrë punët e Vepres një kryetaar; e do kshilltarë; një arketaar e një sekretaar kan per t'ju ndimue n'rregullim e sundim të Vepres. – Kta, sadopak krye mojit do të mlidhen me i rregullue sendet e mrendshme e të jashtme t'Shoqniis. Pater Direktori kaa m'u gjetun nder kto t'mledhuna e asnji send me randsii nuk mund t'dahet paa pelqim t'atii.
8. Paret e Shoqniis nuk mundet kush me i dhanë uhaa a me dever as me i prishun per sende qi mos t'keen të perpjekun me qellim të Vepres Pijore. E madië, per sigurtii e dobiei mâa t'madhe kto pare, poos një sumet t'vogelë, kan per t'u vûu në ndoj Bankë.
9. Ç'do liber i ksaj Veper, para se t'pelqehet per shtampë, do t'kndohet në dorëshkrim prej ndoj Jezuitit; e shkrimtarët do t'poltisin me ju shtrûe gjikimit t'kshillit, per shka i perket shtypunit a mos shtypunit të dorëshkrimit a edhe t'qortuemit t'tii: ne kjoftë se shifet me rrugë me e ndrrue pak a shum mas programit t'Vepres Pijore qi nuk duron kurrfarë sendit qi t'jeen edhe prej s'lergut kundra Fejet a kundra moralit. E prandej lypet qi Shkrimtarët para se t'ja nisin punës s'vet t'merren vesht me Direktorin e me Kshillin t'cillët t'gjikojn a âsht per t'u pelqye landa e librit.
10. Munden me kenë pjestarë të ktii kshillë jo veç Kongreganistat e Zojës Nuncjatë por edhe tjetër kush e sidomos shokët e Rrethit Sh'Jozefit. NB. Duket se ndo tesh me'i herë ndo pak mâa vonë kishte me mujt Vepra Pijore me qitun krye javet a dy herna n'muej fletza flutrojse (foglietti volanti) qi me shum dobiei e të knaqun kishin m'u kndue, sikur i kan kombet tjera t'Europës.
11. Shkrimet qi dona me qitë t'jeen asi sojit qi mund t'i blejn e t'i kndojn edhe ç'do musulman a ortodoks i cilli mos t'jeet fanatik per besim t'vet. NB. Vepra Pijore ja kaa vûu vedit detyren me pague krye vjetit shka t'jeet mangut n'tshitun t'Elciis a t'Lajmtarit t'Zëmers s'Krishtit.

12. *Kshilli zakonisht ndrrohet krye vjetit; kshillit t'vjetër i perket me shënjuhë 3 ëmna ndër t'cillët Shokët ndimtarë në një mledhje mas një konferenzës mii Veprë Pijorë të zgjedhin kryeparin e kshilltarët tjer. Kta mandej me gjithë Direktorin zgjedhin zyrtarët tjerë. T'tre ëmnat munden me kenë edhe t'kshillit vjetër.*

Botimet e Veprës Pijorë

Këto vepra ndahen përgjithësisht në tri grupime kryesore: Kalendarët; Përkthime; Shujta.

Libra të botuar nga shtypshkronja "Zoja e Papërlyeme", seria "Vepra Pijorë" janë këto që po rendisim më poshtë⁴¹:

1. Sh' Eustaki o Familia e martirve: tragjedi me pes hova (Përkthyes: Kolë Thaçi), 1909;
2. Zefi i njoftun: dram n' dy pjesë (Përkthyes: Kolë Thaçi), 1909;
3. Bardhi e Fernandi tu vorri i Karlit IV. Duka i Agrixhentit: dramë me pes hova (Pashko Gurakuqi), 1910;
4. Moji qershorit josë Moji i Zemers t' J. Krishtit, (Përkthyes Enjell Sereqi), 1911;
5. Kalendar i vietës 1912;
6. Muzhiktari i verbët (Përkthyes Antonio Xanoni), 1912;
7. Uratë t' perditçme e do t' lutuna tiera, 1912;
8. Shyhreti i divoçem, 1912;
9. Ligjeratë mii detyrat e trimit / Silvio Pellico, (Përkthyes Gjon Shiroka), 1912⁴²;
10. Kalendar 1913, 1912;
11. Faustini e Gustav Seghetti (Përkthyes Gjon Ujka), 1912;
12. Kalendar 1914, 1913;
13. Kalendar 1915, 1914;
14. Pushka e trathtarit: rromanx historjak (Zef M. Harapi), 1914;
15. Dyy pasqyrat. Julja. Federiku (A. Xanoni, N. Kimza), 1915;
16. Gjenovefja e Brabantit: e dyta dorë / Christoph von Schmid (Përkthyes Anton Xanoni);
17. Vajza e Orleans-it ase Lumja Joana D'Ark (Shtjefen Gjeçovi), 1915;
18. Kalendar 1916, 1915;
19. Kalendar 1917, 1916;
20. E vorfna e i verbti ase rruga e parrizit: tregim (Përkthyes Nikoll Kimza), 1916;
21. Kalendar 1918, 1917;
22. Marija, Zoja e Kshillit t'mirë (Përkthyes, D. Lekë Bitroj), 1918;
23. Kalendar i vietës 1919, 1918;

41 Konsultimi i kësaj liste na u mundësua nga përgjegjësjë e Fondit Albanologjik në Bibliotekën e Universitetit "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës, znj. Olimpia Laca Kakarriqi, së cilës i shprehim gjithë mirënjohjen tonë.

42 Ky libër nuk del askund. Është gjetur te lista e parë që ishte publikuar në kalendarin e vitit 1920-ës (sqarime të O. Laca Kakarriqit).

24. Shyhreti i divoçem: e katërta dor' e shtueme, 1919;
24. Kangë të divoçme: e pesta dorë, 1932; (!)
25. Per natë kazanash (Lazër Shantoja), 1919;
26. Kalendari i vjetës 1920, 1919;
27. Kalendari i vjetës 1921, 1920;
28. Muzhiktari i verbët", e katërta dorë, (Përkthyes Anton Xanoni), 1921;
29. Kalendari i vjetës 1922, 1921;
30. Kalendari i vjetës 1923, 1922;
31. Roza e Tannenburgut. Rromanx i Kristofor Shmidit (Përkthyes D. Llesh Bitroj), 1923;
32. Gjenovefja e Brabantit: bot. 3 / Kristofor Shmid (Përkthyes Anton Maria Xanoni), 1923;
33. Kalendari i vjetës 1924, 1923;
34. Kalendari i vjetës 1925, 1924;
34. Uratë të perditshme e do të lutuna tjera: e dyta dorë, 1924⁴³;
35. Kalendari i vjetës 1926, 1925;
36. Kalendari i vjetës 1927, 1926;
37. Mkati i falshem: sherrija, rrjedhimet e ndeshkimet e tija: kujtime e tregime mbledhë per njerz të përshpirtshëm (Beltrami, Ndre), 1929;
38. Çilci i gazmendit ose Fuqija e Uratës (Alfonso De Liguori), 1930;
39. Vrasa, 1930;
40. Rrime shtremtë e flasim ndrejtë: liber apologije per gjithkend (Kolec Prennushi), 1931;
41. Shkarthi: rromanx i verses rromake, (Souvestre), sjellë në giuhe shqype prej D. Nikoll Gazullit, 1932;
42. Djali i Myftis: tregim i Orientit / Bernard Arens (Përkthyes J. Zekaj).

Një listë tjetër me të njëjtën renditje si më sipër, gjendet edhe në librin e Markus Peters, më e plotësuar për secilën vepër duke dhënë edhe numrin e faqeve të veprave të botuara. Nga këto të dhëna studiuesi gjerman arrin në përfundimin se nga viti 1909-1932, janë botuar 4696 faqe. Sipas Peters janë 42 publikime⁴⁴, pasi numri i botimeve të *Veprës*, i fundit është 42, por meqë veprat me nr. 24 dhe 34, përsëriten dy herë, janë botuar 44 vepra. Për *Veprën* n. 24 *Kangë të Divoçme* (botimi i pestë), në listën e M. Peters vendoset viti 1933 i botimit të saj dhe pse vetë Peters thekson se pas vitit 1932, "Vepra Pijore nuk qe më aktive" dhe flitet "për ndërprerjen" e saj.⁴⁵ Deri në vitin 1914, numërohen rreth 12 libra që kjo *Vepër* ka botuar sipas të dhënave të vjetarit 1915, ku më të përmendurit janë:

43 Numrat 24 dhe numri 34 të series së *Veprës Pijore*, përsëriten 2 herë në vepra të ndryshme (sqarime të O. Laca Kakarriqit).

44 M. Peters, vep. cit., f. 319.

45 Shih M. Peters, vep. cit., f. 157, 310.

- Zefi i njoftun (dram) – e Sh' Eustaki (tragjedi) shkruar prej Zotn. Kol Thaçit;
- Bardhi e Fernandi (dram) qitun prej Zotn. Shuk Gurakuqit;
- Detyrat e trimit (I doveri dell'uomo di Silvio Pellico) kthye shqyp prej Zotn. Gjon Shirokës;
- Muzhiktari i verbët – Faustini – Segheti – Kalendari i vjetve 1911 – 1912 – 1913 – 1914.

Në vitin 1937, në revistën “Leka”, me rastin e 30 vjetorit të krijimit të *Veprës Pijore*, jepet një listë (e plotë për aq sa dihej në atë kohë), e veprave të botuara, deri në numrin e fundit të kalendarit (Kalendari i vjetës 1927) që kjo *Vepër* botoi:⁴⁶

1. Këndime t'kandshme - t'Vepres Pijane - I - Sh'Eustaki - o - Familja e Martirve - Tragedi me pës hova - Ne Shtypshkroje t' Paperlyemes - Shkoder 1909 (në fq. 3: kthye shqyp mbas italishtes [dorëshkrim i sh. XVII-XVIII n'Arkiv Saverjan] - prej Kol Thaçit msues n' Kolegjë t'Shëjtë Sh' Françesk Saverit), 128 fq. in 8⁰ të vogel.
2. Kndime t'kândshme t'Vepres Pijore - 2 - Zefi- i - njoftun - Dram n'dy pjesë - Ne Shtypshkroje t'Paperlyemes - Shkoder 1909 (në fq. 3: Dram i Metastasis - kthye shqyp - prej - Kol Thaçit -Shok i Rrethit Sh'Josefit). 56 fq. in 8⁰ të vogel.
3. Këndime t'kândashme - t'Vepres Pijore - III - Bardhi e Fernandi - tu vorri - i - Karlit t'IV - duka i Agrixhentit - Dramë me pës hova - Shkoder - Ne Shtypshkroje t' Zojës Paperlyeme 1910 (në fq. 3: kthye shqyp mbas italishtes - prej - Pashko Gurakuqit - mbsues në Kolegjë t' Shëjtë Sh' Françesk Saverit), 96 fq. in 4⁰ të vogel.
4. Vepra Pijore N. IV. - Moji - i - Qershorit - Shkoder - Shtyp. e Zojës Paperlyeme 1911 (në fq. 3: M.i Q. - josé - Moji - i Zëmërs t'J. Krishtit- qitun n'giuhë Shqype - prei - P. Ënjell Sereqit i Shoqnís t'Jezu). 320 fq. in 8⁰ të vogel.
5. Vepra Pijore N. V. – Kalendari - i vietës - 1912- Shkoder Shtypshkroja e Zojës Paperlyeme [1911] 56 fq. in 4⁰ të mesem.
6. V. P. N. VI - Mushiktari - i verbët - Shkoder Sht. e Zojës Pap. [1912]. 44 fq. in 4⁰ të mesem (aukt. Fr. von Seeburg, perkth. Atë A. Zanoni S.J.).
7. V. P. N. VII. Uratë - t'perditshme - e do t'lutuna tjera - Shkoder - Shtyp. e Z. s'P. 1912. 1 formë 32 faqesh së vogla.
8. V. P. N. VIII- Shyhreti - i - Divoçem - e treta dor' e shtueme - Shkoder - N' Shtyp. t'Z. s'P. 1912. 116 fq. in 8⁰ të vogel.
9. V. P. N. IX. - Silvio Pellico - Ligjeratë – Mii - Detyrat - e trimit - perkthye shqyp - prej Gjon Shirokës - Shkoder - Sht. Z. P. 1912 156 fq. in 4⁰ të vogel.

46 “Veprimi i V. P. – Vargu i botimeve”, *LEKA*, 1937, n. 6, f. 268-270.

10. V. V⁴⁷. N. X. - Kalendari – 1913 - Shk. Sht. e Z. P. - 1912. 60 f. in 4⁰ të mesem.
11. V. P. N. XI. - Faustini e Gustav Seghetti - Shk. - Sht. e Z. P. - 1912 [perkth. Gjon Ujka]. 44 fq. in 4⁰ të mesem.
12. V. P. n. XII - Po leen diilli, Kaa prendue hâna - Kalendari - 1914- Shk. - Sht. Z. P. - 1913, 48 fq. in 4⁰ të mesem.
13. V. P. N. XIII - Kalendari - 1915 - Shk. - Sht. e Z. s'P. 1914. 72 fq. in 8⁰ të mesem.
14. V. P. N. 14 – Pushka - e - Trathtarit - Rromanx historjak Shqypniet - perbâa prej - Zef M. Harapit - Shkoder [Sht. e Z. s'P.] – 1914, 204 fq. in 8⁰ të mesem.
15. V. P. N. 15 - Dyy Pasqyra - e dyta dorë - Shk. - Sht. e Z. s'P. 1915 (Në fq. 3: Gjon Schoepti - Julja - Shqypnue prej Ant. M. Xanonit S.J. - në fq. 1 të formës 7: Federiku - Kthye shqyp prej D. Nikoll Kimzes 84 + 26 fq. in 8⁰ të vogel.
16. V. P. N. 16 - Gjenovefja e Brabantit – shqypnue - prei - Ant. M. Xanonit S.J. - e dyta dorë - Shk. Sht. e Z. s'P. - 1915 (në fq. 1: Prej M. Kristoforit Shmid). 162 fq. in 4⁰ të mesem.
17. V. P. N. 17- Joana d'Ark – shqypnue - prej A. Sh. K. Gjeçov, O. F. M. - Shk. - Shtyp. e Z. s'P. (në fq. 1: mas A. F. prej Bergamos - O. M. Cap.). 176 fq. in 4⁰ të vogel.
18. V. P. N. 18 - Kalendari - 1916 - Shk. Sht. e Z. s'P. - 1915. 84 fq. in 4⁰ të mesem.
19. V. P. N. 19 - Kalendari - 1917 - Shk. Sht. e Z. s'P. 1916. 88 fq. in 4⁰ të mesem.
20. V. P. N. 20 - E Vorfna e i Verbtit - asé - Rruga e Parrizit - Perkthim - i t'Nder. D. N. Kimzes (në fq. 1: tregim - perkth. p. t' Nd. - D. Nikoll Kimzes – i Djoçezit t' Lezhës). Shkoder – Sht. e Z. s'P. - 1917 (në fq. 1: 1916). 72 fq. in 4⁰ të vogel.
21. V. P. N. 21- Kalendari 1918- Shk. - Sht.- e Z. s'P. – 1917. 112 fq. in 4⁰ të mesem.
22. V. P. N. 22 - Marija - Nana e Kshillit t' Mirë - Kthye shqyp - prej - Dom Lekë Bitrojt - Shk. Sht. e Z. s'P. - 1918 (fq. 3: mas t'katertes dore tedeshke - t' Atit H. Dach O. S. Aug.) 160 fq. in 8⁰ të vogel.
23. V. P. N. 23 - Kalendari – i - vjetës - 1919 - Shk. - Sht. e Z. s'P. - 1918. 104 fq. in 4⁰ të mesem, brochure.
24. V. P. N. 24. – Shyhreti - i - Divoçem (në fq. 1: e katerta dor' e shtueme - Shk. -Sht. e Z. s'P. 1919) 144 fq, in 8⁰ të vogel, brochure,
25. D. Lazer Shantoja - V. P. N. 25 - Per natë Kazanash - Shkoder - Sht. e Z. s'P. [1919] 192 fq. in 8⁰ të vogel.
26. V. P. N. 26 - Kalendari- i - vjetës-1920 - Shk. - Sht. – e Z. s'P. (në fq. 1:

47 Gabim shtypi, pasi do ishte dashur P [Pijore].

- 1919), 104 fq. in 4⁰ të mesem, brochure.
27. V. P. N. 27 – Kalendari - i - vjetës - 1921 - Shk. - Shtyp, e së P. [1920]. 96 fq. in 4⁰ të mesem.
 28. V. P. N. 28 - [F. v. Seeburg - Xanoni] Mazhiktari - i verbët - E katerta dorë - Shk. Sht. e së P. - 1921. 68 fq. in 4⁰ të mesem.
 29. V. P. N. 29 - Kalendari - i vjetës - 1922 - Shk. Sht. e së P. 1921. 84 fq. in 4⁰ të mesem, brochure.
 30. V. P. N. 30 - Kalendari - 1923 - Shk. Sht. e së P. -1922. 88 in 4⁰ të mesem, brochure.
 31. V. P. N. 31 - D. Llesh Bitroj - Roza - e - Tannenburgut - Rromanz - i Kristofor Schmidit - Shkoder, Sht. e së P. 1923, 168 fq. 4⁰ të mesem, brochure.
 32. V. P. N. 32 - Gjenovefja - e - Brabantit - (Prej M. Kristofor Schmidit) - shqypnue - prej Ant. M. Xanonit S. J. e treta dorë - Shkod. Sht. e së P. - 1923. 152 fq. in 4⁰ të mesem, brochure.
 33. V. P. N. 33 - Kalendari - 1924 - Shk. - Sht. e së P. - 92 fq. in 4⁰ të mesem, brochure.
 34. V. P. N. 34 - Uratë të perditshme - e - do të lutuna tjera - e dyta dorë - Shk. Sht. e Z. së P. 1924. Formë 36 fq. së vogla.
 35. V. P. N. 34 [sic!] - Kalendari - i - vjetës 1925 - Shk. - Sht. e së P. [1924]. 78 fq. in 4⁰ të mesem, brochure.
 36. V. P. N. 35 - Kalendari - 1926 - Shk. - Sht. e së P. [1925], 92 fq - in 4⁰ të mesem, brochure.
 37. V. P. N. 36 - Kalendari - 1927 - Shk. – Sht. e së P. - 1926 - 92 fq. in 4⁰ të mesem, brochure.

Në fund materiali mbyllet me këtë përmbledhje të listës: “Janë prá 3 drama, 4 vepra poetike, 10 romanxa a kallxime, 1 jetëshkrim, 16 kalendarë me landë të ndryshme morale, letrare, historike, ditunore e zbavitse, 1 veper fjesht zbavitse, 1 morale, 6 të divoçme.”

Kalendari i Vjetës, nuk vazhdon më pas vitit 1927 dhe në faqen e fundit të “Lajmëtarit”⁴⁸, lajmërohet botimi i “Shqypnija e Ilustrueme”, si *Kalendari i vjetës perishtupe 1928*, me përmbajtjen e materialeve. Te botimi i “Shqypnija e Ilustrueme”⁴⁹, drejtimi i Shtypshkronjës sqaron: “Tuj pasë dá “Vepra Pijore” qi mos m’e botue mâ Kalendarin e vet, kjo Shtypshkroje e së Paperlyemes e ká marrë mî vedi botimin e një kalendarit të pervjetshem, por me një tjetër qellim. Kalendari në fjalë, sikursé shifet, bán êmnin SHQYPNIJA E ILUSTRUEME e qellimi i tí ka me kênë per gjith vjetë me pershkrue e me ftyrzue Shqypnín, tuj mârrë ka një ka një të gjitha gjytetet...”.

Vepra Pijore i ndërpreu aktivitetet e saj për mbështetjen e letërsisë

48 *Lajmëtarit i Zemres s’J. Krishtit*, 1928, n. 1.

49 *Shqypnija e Ilustrueme, Kalendár i vjetës perishtupe 1928*, f. 9.

në vitin 1932, në kohën kur drejtohej nga Atë Zef Saraçi. Albanologu Atë Zef Valentini S.J. (1899-1979) kishte marrë përsipër të vazhdonte më tej detyrat e *Veprës Pijore*⁵⁰. Formalisht vazhdoi të ekzistonte deri në vitet 1945/46, siç dëshmohet nga katalogët e Provincës Venete⁵¹.

Kalendari i Vjetës (Kalendari Vjetar)

Një vend të rëndësishëm dhe kryesor në botimet e *Veprës Pijore*, zë *Kalendari i Vjetës*, tashmë i pranishëm në Bibliotekën Kombëtare Digjitale. Ky kalendar, si botim i *Veprës Pijore*, është shtypur në shtypshkronjën e *Zojës së Papërlyeme* nga viti 1911-1926; gjithsej 16 kalendarë (Kalendari Vietar 1912 – 1927). Kalendari përmban festat fetare të çdo muaji dhe lëndë kulturore, letrare, historike, fetare, kronologjike, ngjarje, kuriozitete etj. Rëndësia parësore e këtij kalendari ishte “mbështetja e formimit të përgjithshëm në popull”⁵². Në disa prej tyre janë përfshirë edhe vepra letrare, që më pas janë botuar si libra më vete. Te kalendari i botuar në vitin 1921, ka një poezi që i kushtohet lexuesve të këtij kalendari, ku vlerësohet puna e tij ndër këto vite:

*“Ky kalendar me fuqina të vetat
Për dyndhetë vjet â rrit aq fort në Shqypni
Sá ânë e skâj n’per Shkoder po i rreh fletat
E dér në Prevezë permëndet êmni i tî”*⁵³

si dhe urohet jetëgjatësi e lexim pa zhgënjime për atë që ky kalendar prezanton në vetvete.

Brenda faqeve të kalendarëve, botohen shkrime nga personalitete të njohur të letrave si: Filip Shiroka, Lazër Shantoja, Preng Doçi, Filip Fishta, Antonio Xanoni, Gjon Gazulli, Xhevat Korça, Ernest Koliqi, Kristo Floqi etj. Një listë më e plotë e të gjithë autorëve që publikuan në kalendarët vjetorë të *Veprës Pijore*, gjendet në veprën e Markus W. E. Peters [2016, f. 319] ku mund të shtojmë: Gjon Luigj Bazhdarin S.J., D. Nikollë Gazulli, Francesco Genovizzi S.J., Shtjefën Gjeçovi OFM, Pashko Gurakuqi, Mark Harapi S.J., Zef M. Harapi, D. Nikollë Kimza, Mati Logoreci, Leonard Martini OFM, D. Kolec Prennushi, D. Zef Ramaj, Zef Saraçi S.J., Engjëll Serreqi S.J., Gjon Shiroka, D. Aleksandër Sirdani, Kolë Thaçi, D. Nikoll Tusha-Nogaj, Gjon Ujka, Ndoc Vasija, Shtjefën Maria Zadrima S.J., Jak Zekaj, Atë Alessandro Fracchioni S.J.⁵⁴ Përveç emrave që kanë kontribuar direkt me botimet

50 M. Peters, vep. cit., f. 149.

51 Po aty, f. 309-310.

52 Po aty, f. 314.

53 *Kalendari Vjetar*, 1922, f. 19.

54 M. Peters, vep. cit., f. 314.

e tyre në kalendarë, vihen re shkrime nderuese e vlerësuese për njerëz të letrave shqipe. Kështu në nderim të Atë Gjergj Fishtës, janë botuar 10 tingëllima me titull “Ave Scodra!” (kalendar i vitit 1924), nënshkruar në fund nga Filip Fishta. Po ashtu në faqet e kalendarëve, bëhen të njohur figura të letërsisë sonë që akoma në ato vite, nuk e kishin fituar famën që kanë sot. I tillë është shkrimi me titull “Do shkrimtarë gadi t’paanjoftun” (Kalendar i 1920-ës, f. 99) ku jepet puna e vyer e autorëve që kanë hedhur dritë mbi kombin, gjuhën dhe letërsinë shqiptare si: Jul Variboba, Françesk Anton Santori, Jeronim de Rada⁵⁵, Zef Serembe, Êjell Bazile, Gabriel Dara, Demetrio Kamarda duke mbyllur artikullin me kërkesën për t’u kujdesur edhe për “dialektin e atyne 250 mii ltli – shqyphtarve qi nder Kalabri e n’Siçile” janë munduar këto 50-60 vjet në përparimin e literaturës dhe gjuhës shqipe. Kalendar i sjell gjithashtu në faqet e tij dhe emra të njohur të letërsisë botërore me shkrime që nga Homeri te Aleksander Manzoni, Oskar Wilde etj.

Kalendar i është vjetor fetar, me të dhëna për çdo muaj të festave fetare kristiane po edhe me të dhëna të tjera si: ndërrimi i hënës, koha e celebrimit të dasmave, të dhëna meteorologjike si dhe ndonjë njoftim tjetër që vjen e pasurohet më tej nga kalendar i në kalendar. Gjuha me të cilën përcillen shpesh këto njoftime është e bukur në thjeshtësinë e saj dhe ndonjëherë argëtuese, si p.sh. të bëjmë përshtypje shprehjet e përdorura në kalendarin e 1915-ës, në faqet 17-18 në rubrikën “Ç’farë motit do t’kena simjet neper Shqypni?”, të tipit:

Korrik: *Nji duhii bâmirse ndalon t’shtuemit e t’xetit. Dit bash t’xeta qi t’bajn me dishrue nji shii.*

Gusht: *Fillon me na merzitë prep t’xetit.*

Tetuer: *Duhet me qitë jashta fanelat pse ndihet t’ftofet.*; shprehje që i shmangen regjistrin formal të një shpjegimi të motit dhe sillen bukur e pranueshëm për një lexues të thjeshtë. Është karakteristikë e *Kalendarit* që të sjellë me një gjuhë sa më të këndshme e larg formalizmave të tepërta çdo informacion. Duke filluar nga kalendar i 1923-shit jepen njoftime edhe për festat kryesore të besimit mysliman si: Bajram apo Ramazan. Po nga ky numër në kalendarin fetar ka një shënim për emrat e shenjtërve shqiptarë që janë të dallueshëm me një yll (*), si dhe theksohet në faqen e parë të kalendarit fetar se “janë të Shqypënis s’onë pse ndo kan lé prej gjakut e gjinís s’onë, ndo kan punue a janë martirixue nder né per punë të Fés qi ishin tuj jau msue të parve t’onë”, apo si vijon te kalendar i 1927-ës se

55 *Kalendar Vjetar*, 1920. Te De Rada artikullshkruesi ndalet më gjatë duke e vlerësuar si më të madhin ndër poetë shqiptarë dhe veprën e tij “Rapsodie d’un poema Albanese” e quan “L’Omero Albanese”, një poem historik që përmbledh këngët popullore dhe “kndon poetisht e atdhetarisht s’parit shtetin e gjëjen e liir t’Shqypniis para se t’a pushtonin Anadollakët”.

mund të jenë edhe të huaj që “kan bâ deken per Fé të Krishtit në Shqypni”.

Të dy Kalendarët 1913-1914, kanë një shpjegim historik për konceptin e kalendarit vjetar të festave fetare se si ka nisur që në zanafillë, prejardhjen dhe historikun e tij, si një “Al manâ” e cila “harapçe do me thanë t’njehun, që ishin dikur *ditore astronomike themelue n’shikim t’hyjeve*.”⁵⁶ Në kalendarin e vitit 1925, në një material tepër interesant tregohet historia e ekzistencës së muajve të vitit e ditëve të tij që në zanafillë. Që nga Konkili i famshëm i Niçes, në vitin 325 “kje dá mâ s’parit m’e konsideruem një herë e per gjithmonë ekvinocin e Prëndverës me 21 Marc, në të cillen ditë bite aso kohet ... mrapa vëndoj qi festa e Pashkëve të kremtohej në të paren Dielë mas hânes – plotë, qi bân o ditën e ekvinociit o mrapa; asë, me fjalë tjera, të Dielen qi vjen masi hâna e ré e Marcit të ken mushë 14 ditë”⁵⁷, duke caktuar kështu festën e Pashkëve, jo para 22 marsit e jo pas ditës 25 prill.

Një rubrikë që nis nga kalendarin e vitit të parë është ajo me disa të dhëna për shtete të ndryshme evropiane, që kristalizohet numër pas numri. Në numra të ndryshëm, kalendarin informon mbi numrin e popullatës, drejtuesit e këtyre vendeve dhe të dhëna të tjera që shfaqin interes për kohën (p.sh. Shqipëria ka një popullsi si “sundim i pertashem, popullimi 1 milûu”). Me emërtimin “Shtetet mâ t’parat”, apo edhe “Gjytetet mâa t’mdhajat e botës” jepen të dhëna për shtete apo qytete të ndryshme në Evropë, Amerikë e Azi. Në Kalendarin 1916-ës në një informacion të detajuar për shtete të ndryshme të Evropës, po shkëpusim një model:

Greçia

Krajlni me km² 115,975 e banorë 4,256,000.

Besimi: Mâa e shuma ortodoks; por kaa edhe 44,265 katolik.

Kryegjyqeti: Athina me 167,479 banorë, n’vjetë 1907.

Krajli. Kostandini i Deres s’Slesvig Holstejn leu me 2 korrik 1868, u martue me Sofiin princeshen e Prusjes me 27 tetuer 1889.

Trashigimtari, Gjergji leu me 19 korrik 1890.

Ushtria. N’kohë t’pagjës nja 40,000, n’kohë t’luftës mâa se 300,000.

*Doname nja 40 t’mdhaja e t’vogla*⁵⁸.

Çdo material i hedhur mbi ndodhitë në vende të ndryshme, bëhen me qëllimin kryesor të krijimit të *Veprës Pijore* që është përhapja e kulturës, dijes te të rinjtë e në popullatë. Kjo gjë citohet edhe në kalendarin e 1922-shit, pasi “si xânsat e shkollave si edhe na qi jena rrit’ e bâ burra kemi nevojë me dijtun se si janë ato sot sidomos per kah popullsija”.

Mund të themi se materialet që gjenden në të gjithë kalendarët bëhen

⁵⁶ *Kalendarin Vjetar*, 1914, f. III.

⁵⁷ *Kalendarin Vjetar*, 1925, f. 25.

⁵⁸ *Kalendarin Vjetar*, 1916, f. 22.

më interesante e më të bollshëm numër pas numri, me informacione nga fusha të ndryshme si: biologjia, gjeografia, arkeologjia⁵⁹, të cilat vënë në dukje edhe objekte me rëndësi arkitekturore dhe historike; ka përshkrime të qyteteve kryesore, si: Korça, me cilësimin e njohur Paris i vogël, cituar prej një konsulli francez; Gjirokastra, "nji vend maluer e ndermjet të grykave, e prandej dán si me kënë nji kështjell a kalá natyre";⁶⁰ Shkodra me një material të mirë historik që nga koha e Gencit deri në kohën e dorëzimit të saj në duart e turqve (1477);⁶¹ Vlora "si ma i miri limâ tregtár i Shqypnis, e pernjiherë, si vend strategjik, mâ i vjefshmi i dedit Adriatik"⁶², apo edhe Tirana, Përmeti, Elbasani etj. Një informacion interesant (kalendari i vitit 1923), është ai për qytetin e Dêjes ku një ndër kishat e atij qyteti, një ndër monumentet më të hershme të arkitekturës e të pikturës që ka patur dikur Shqipëria, 700 vjet e deri tani është si përmendore e vogël e Dêjes së moçme "nji provë e kjarhtë qi dishmon se hartet nder né ishin at herë shum mâ në lulxim se sot"⁶³. Bëhet një përshkrim i shkurtër i Turqisë në drejtimin e "Zâmadhit Qemal Pasha", me pyetjen e kalendarit "a thue e kan qitë Turkín e ré në rrugë të perparimit a të prishnit? Historja ka per t'a diftue."⁶⁴

Lidhur me figura të shquara historike, përkujtohen emrat e personaliteteve vendas e të huaj që meritojnë kujtesë për kontributin e tyre si p.sh.: Hasan Riza Pasha, Pater Luigj Paliq, Pater Dedë Pasi, Gjin Pjetri i Skuraj, Agostin Cypriani, Koloneli Thomson, Dedë Gjo Luli etj. Një tjetër figurë është ajo e Bajram Currit, i shquar për vetmohimin e tij, i padorëzueshëm para çdo pengese me të vetmen dëshirë, "me u shkri nder kto male me gjâ e me jetë... qi Kosova të jesin vetun e Shqypnis"⁶⁵. Por edhe figura si: Kostandini i Madh, Princ Vidi⁶⁶, Napoleoni I⁶⁷, Benito Mussolini⁶⁸, bëhen pjesë e këtyre përshkrimeve.

Kalendari i kushton vëmendje trashëgimisë së letërsisë popullore, për të mbledhur gojëdhana e *ndollina* si mundësi "me lshue nji fije dritë mii historii t'Shqypniis"⁶⁹. Në kalendarin e vitit 1927, në një shkrim me titullin:

59 Sënde rromake e prehistorike të gjetuna nder rrethe të Shkodrës, shih: *Kalendari Vjetar*, 1922.

60 *Kalendari Vjetar*, 1924, f. 59.

61 *Kalendari Vjetar*, 1915.

62 *Kalendari Vjetar*, 1924, f. 83.

63 *Kalendari Vjetar*, 1923, f. 76.

64 *Kalendari Vjetar*, 1924, f. 56.

65 *Kalendari Vjetar*, 1925, f. 45.

66 Në brendësi të Kalendarit të vitit 1914 riprodhohet fotoja e Princ Vedit me shënimin: "Princi Guljelm Wied leemun me 27 t'qershorit 1872".

67 *Kalendari Vjetar*, 1914, f. 28-31.

68 *Kalendari Vjetar*, 1924.

69 *Kalendari Vjetar*, 1920.

“Po prrallat çka duhen?”, shpjegohet rëndësia e tyre dhe fakti se as retorika më e mirë nuk arrin të shkojë në veshin e duhur përballë tyre. Në përforsim të këtij pohimi silltet edhe fakti se të njëjtën gjë besonte edhe La Fonteni se njerëzimi “â nevoja m’e marrë me të mirë e m’e argtue si fëmín”. Prandaj përgjithësisht asnjë vend nuk i ka përbuzur “kallximet popullore” të vendit të vet po me një kujdes të posaçëm i ka mbledhur, i ka shkruar dhe botuar e i ka ruajtur si gur të paçmuar të visarit kombëtar. Në kalendarin e 1915-ës, një “kalxim” nga dom Zef Ramaj, me titullin “Qeli – a një farë Nastradinit i Kosovës”, “â shkruie Kosovçe” dhe është ruajtur në dialekt nga botuesit me qëllimin për ta pasuruar gjuhën “me t’foluna t’dialektave tjerë qi s’janë paa hjeshtie e qi nuk doon lanë n’njën’ ânë”. Për arsye të *kalximit* në këtë dialekt, përgëzohet “me Parii t’ *Veprës Pijore*”⁷⁰ edhe Lumo Skendo nga Sofja. Disa përralla të tjera janë: “Fialë e hallkut e birat e gardhit s’mudhen kurr” (rrëfim në vargje me ilustrime), “Mâ zi gergasi se vetë dorëras” (nga dom Lekë Sirdani), “Si një sherbtore mbyti 40 kusarë” e “1001 netëve” (përkthyer nga Mati Logoreci) etj. Shkrimi mbi një rapsod me titull “Poeta i Kabashit” i dom Lazer Shantoja (Kalendari i vitit 1921), është në vazhdë të rëndësisë së mbledhjes së krijimeve popullore, si një visar i çmuar dhe pasuri e këtij populli. Shantoja thekson ndër të tjera “se kangët mâ të bukura na vin prej Puket” e poeti me emrin Prendush Gega përcillte këngët e veta me lahutë e të bënte të ndieje se “kishe bâ ... një të kthiem mrapa 4000 vjetësh...”. Aq natyrshëm i dilnin, sa të mbeteshe i shtangur prej kënaqësisë “veç tuj lexue me pak kujdes e mas pikpamjes etnologjike njikto pak “kasha e lasha” qi kena shkruie tuj mbledhë prej gojës t’popullit...”⁷¹

Materiale të tjera brenda kalendarit janë: humor, lojëra matematikore apo lojëra fjalësh. si: sharada, monoverb apo rebus që shoqërohen edhe me modele, apo kuriozitete. Si lojë argëtuese “T’Pvetuna-t” janë interesante për humorin e zgjuarsinë që përcjellin. Janë një *t’pvetun* që mbyllet me humor: *Kush di me i folë t’tana giuhët? – Jehona*.

Në këtë pikë mund të rendisim edhe botimin numër 25 të *Veprës Pijore* me titull “*Per natë kazanash*”, një përmbledhje me lojëra, cashë e lasha apo proverba, shkruar nga Lazer Shantoja. Më mirë për të mund të përdorim një dialog prezantues me titull “*Edhe vetë do t’a blejë*”, shkruar në Kalendarin e Vjetës 1923⁷²:

- *Nji liber të bukur kam kndue nder kto dit; tuj e knduemun kam xânë do msime të kândshme fort, por edhe jam fikë gazit.*

- *Po kû e gjete a kû e bleve at liber?*

- *Në shtypshkoje të Paperlyemes, nder Jezuit, ktu në Shkoder.*

- *Po a bân shtrêjt?*

70 Kalendari Vjetar, 1916, f. 34.

71 Po aty, f. 78.

72 Po aty, f. 60

ëndetoria (një lloj si furka), *fershlitshin* (pëshpërisnin), *rrahader* (lypës), *shkafnyhen* (copëtohen), *bajshin pallamaça* (përplasnin duart), *parprindve* (paraardhës), *mungarë* (murgjër), apo shprehje si: “qyshë kohen e Nduthit graat kan dalë n’zâa per giûhë qi kan!; Kok-fyell kush kapet me juul; Na trima flasim, ju graa vertlloni!”, të gjitha sillen bukur në përkthimin shqip. Historia përcjell devocionin ndaj Zotit dhe mirësisë që vjen prej tij, e treguar pa euforira besimi dhe moralizime të forta si dhe shijohet në çdo faqe. Si një gjuhë e pranuar afër lexuesit vjen dhe shprehja *Atynë*, në vend të Ati Ynë (“kam me e thanë një Atynë per t’gjith t’verbtit e botës...”⁷⁵), si për ta sjellë në gjuhën e përditshmërisë, siç thuhej nga njerëzit e thjeshtë. Pjesa është e shoqëruar nga shtatë vizatime që e bëjnë më interesante, “... per ndaar prei fort t’Perndritçmit Zotni Friedrich Pustet, i cilli me Shtypshkroje t’vet Papnore (n’Regensburg, n’New York e n’Cincinnati) bukur mirë i përkrahet Chashties Katolike.”⁷⁶

Në këtë kalendar të parë, aspekti historik përcillet me historitë e 14 shenjtoreve me origjinë shqiptare, jetuar në kohëra të ndryshme. Në muajin maj, për t’u veçuar, në datën 26 përmendet Sh’Eleuteri Papë, si datë përkujtimore e largimit të tij nga jeta. Të dhënat që sillen në kalendar thonë: “i jati i tii e pat êmnin Abunëd. Atdheu i tii kie Nikopolli vënd afer Prevezes. E sũndoi kishen Shêite nen Mark Aurelin e nen Komodin. Suell prei fees t’Krishtit shũm Rromak fisnikë. Ky dergoi n’Britanie Shêitin Sh’Damian e Shêitin Sh’Fugac t’cilët pagzuene Luçin mret me t’shoqen e gadi me t’gjith popullin marë. Diq me 26 n’Majë e sũndimin e kishes katolike e maiti ç’prei vietës 179 e deer n’vietë 194. Korpi i tii kie vorrue brfi korpit t’Shêitit Sh’Pieter Apostull. Kie i pari Papë qi e pat t’leemit n’Shqypnii. (prei Martiologut e prej shkrimtarit Çezar Baronit)”⁷⁷

Kalendari i vitit 1913 (Vepra Pijore N. 10, botuar në vitin 1912) është më cilësor, me foto me ngjyra dhe fillon me një lutje adhurimi ndaj Jezusit e disa shprehje për librat. Si krijimtari letrare e përfshirë në këtë kalendar, është “Faustini” përkthyer nga Gjon Ujka⁷⁸, një histori jete e marrëdhënieve të fëmijës me prindin. Në të flitet për një kopshtar, apo *lulnatar* e *lulishtaar* si e quajnë në tregim, i larguar nga familja prej xhelozisë e sherreve, me mendjen e një djaloshi rebel, por që vuan për vite të tëra mungesën e familjes. Dhe pse kudo që shkon gjen njerëz të mirë që e mbështesin fort, mendja e tij është aty ku ka babain e vëllain. Ai (Faustini) kthehet më në

75 *Kalendari i Vietës*, 1912, f. 2.

76 *Kalendari i Vietës*, 1912, f. 44.

77 Po aty, f. 46.

78 Gjon Ujka ka qenë një aktivist i dalluar i çështjes kulturore dhe në vitet ’30 figuron si pronar i së përkohshmes “kulturale popullore” *Cirka*, e cila korri sukses të merituar asokohe nën drejtimin e Cuk Simonit.

fund pranë njerëzve të dashur me një barrë urti e vlerësim mbi familjen, besimin, shkollimin, të mirën e mbi të gjitha respektin e dashurinë prindërore. Rëndësia që ka fëmija për ta respektuar e nderuar prindin, lidhet edhe me kujdesin që duhet të ketë prindi në ushqimin me dashuri të fëmijës së tij. Asgjë nuk vjen nga ajri; atë që do të mbjellim, do ta marrim në këmbim. Tregimi tjetër i përfshirë brenda kalendarit është “Gustav Seghetti” një tregim prej shtatë pjesësh, përkthyer po ashtu nga Gjon Ujka në vitin 1912 (firmosur në fund me inicialet U. G.). Kjo pjesë letrare bashkë me “Faustinin”, figuron si vepër e veçantë me numrin rendor 11 në listën e *Veprës Pijore*. “Gustav Seghetti” është historia e njeriut të vetmuar që jeton në mjerim; historia e një ushtari, që vuan pa prindër e pa asnjë mbështetje në jetë. Që në fillim të tregimit, autori shpalos tërë fabulën e jetës së *Seghettit*, i cili do të dënohet me vdekje, por që me ndihmën e priftit arrin të kthejë sytë kah besimi e të lërë për secilin lexues një provë jete tek e vërteta. Kështu, duke jetuar jetën e rrugës “shokt e mrapsht, dishiri i liriis me një madhshtii e mnii sgiedhet, kah’ e mrapshta, te pija e te loinat” e deri te vrasja e “nji kryepaar” në ushtri, të gjitha këto pas vendimit të gjyqit ushtarak, e çojnë drejt dënimit me vdekje Gustavin. I dënuari me vdekje, afrimin drejt besimit para pushkatimit, e sheh si shpëtim. E gjen zgjidhjen të lidhur tërësisht me rrugëtimin e njeriut “në atë që e pret pas”. Sa ka jetë mund të rregullosh çdo gjë; me vdekje njeriu nuk ka më mundësi. Pjesa letrare të sjell ndërmend historinë e Mersoit të Kamysë, por me vështirimin lart. Ka një lloj shprese në këtë rrëfim, ndryshe nga pesimizmi pa rrugëdalje i të huajit Merso.

Kalendari i vitit 1914 (Vepra Pijore N. 12, botuar në vitin 1913), për vetë vitin që i kushtohet, ky kalendar sjell mjaft material historik. I pari është “Çarkimi i Shkoders” (8 tetor 1912 – 14 maj 1913) me nëntitull “Shkaqet e luftës”. Ngjarjet fillojnë rrëfimin e tyre që prej vitit 1910 kur “mundohej Mali i Zii m’u xânë me Turk” e kur “në vjetë 1911 Malcorët e Miishkoders filluene luften kundra Bedri Pashës” që dhe pse “Knâzi u çoi ndimë kaçakëve nja 100 vetë” nga ana tjetër i dërgoi fjalë “Valiis: M’a xên, të lutem, njatë çetë Malazeze qi kaa ikë prejë irdiis s’eme e â bâa me malcorë”.⁷⁹

Ngjarjet tregohen me data e shifra mbi ato momente historike e vite të vështira për vendin tonë, në prag të Pavarësisë apo dhe L1B që ne tashmë i njohim. Në pjesën “Lufta, Çarkimi e Uja”, flitet për një ultimatum që bën Mali i Zi më 8 tetor 1912 dhe marrjen e kalasë së parë, asaj të Tuzit me ndihmë të malësorëve të Mbishkodrës. Ditën e 11 tetorit ora 11.30 “topa të mdhaj ushtojshin fort mâa andej Shiroken e një breshnii plumash qi ndihej edhë në Shkoder diftojshin se Turqit ishin ndeshë me Malazez”. Të nesërmen tregohet se “katundet e Zogaj po digjeshin e njerëzit prej andej

79 *Kalendari Vjetar*, 1914, f. 1.

e prej Shirokës po merrnin arratinë”. Malazezët kishin zaptuar Anën e Malit dhe kishin dalë në Obot me synim marrjen e rrugës së Shëngjinit, për të penguar ndihmën prej Venedikut për Valiun e Shkodrës. Më 17 tetor bëhet një luftim i ashpër në Koplik, ku malazezët plaçkitën e dogjën atë zonë për dy ditë. Gjylet e malazezëve vërviteshin përditë nga Taraboshi e turqit nuk pushonin duke iu përgjigjur po me gjyle. Banorët ishin larguar, dhe në këto ditë luftimesh “nder smuetore të Shkoders gjindeshin nja 5000 luftarë të varruem”. Në vijim të materialit tregohet se më 30 tetor, prej Vrakës, bombardimi malazez nisi mbi Shkodrën e gjylet nuk pushuan për muaj rresht duke synuar shkatërrimin absolut të shkollave të krishtera dhe të një ndërtese fretërisht të cilat u vinin në ndihmë jetimëve, vetëm pse ishin “nen projtii të Austris, e cilla i kundërshtote Malit të Zii me pushtue Shkodren”. Hasan Riza Pasha u kishte marrë për hesap të mirëmbajtjes së ushtrisë ndër manifaktura e dugaja ato ditë rreth “2 milÿ grosh gjaana” dhe në këtë kohë, kur njerëzit i largoheshin rrethinave e kërkonin strehë në Shkodër, gjindja ishte shumë e për të gjitha këto arsye filloi të ndihej uria dhe zija. Vërehej se si 60-70 veta burra, gra e fëmijë vërdalloseshin me orë nëpër radha për një kafshatë bukë e shumica mbeteshin pa ngrënë. Më 28 kallduer (janar) u mbyllën gati të gjitha furrat e bukës. Më 30 të këtij muaji i bënë një atentat me vdekje Hasan Pashës dhe prej kësaj dite e deri në 9 februar (shkurt) përplasjet vijuan më të forta. Në të dielën e 9 shkurtit, thonë se luftimet zgjatën pa pushim “60 sahat e metnë 5500 Malazez”. Qindra trupa “të dekunish turq u kalbne mii dhe deer qi hini Mali i Zii në Shkodër. Të diil mrama pushoj leftimi gadi unjii e gjithkush ndiite nevojë me fjetë mas trii ditsh të kalueme”⁸⁰

Kjo situatë e vështirë tregohet me detaje ditë pas dite se si njerëz të pafajshëm mbyten nën gjylet malazeze (*Mali i Zii vervitëte gjyle sidomos në kështënim, thuhet specifikisht*). Rënia e Shkodrës në duar të malazezëve jepet edhe si dëshmi përmes dokumenteve, përpos përshkrimit të atyre që e kanë përjetuar. Dokumenti i lëshuar nga Esat Pasha më 23 prill 1913 thotë: “Shtat muej rresht kalaja e Shkoders, paa i ardhë nimë kerkah, u bani ballë fuqiive t’anmikut, e sot me pikllim të foort po shef, se nozullat (ushqime – vettovaglie) qi kaa mrëndë, s’po mastojnë veç se per nji ditë me e majtë ushtriin në kamë. Tujë pasë vojtun puna në ket krajatë (hall) e tujë paa, se as per Qeverii as per ket vend s’po m’del me xjerrë kurnji prodhë (dobi), i pështetun themeniive (qyshkeve – patii) rreshtue ktû poshtë une po ja lëshoj pritrat (istikame – trince) ushtriis të Malit Zi, e po nisem per Tiranë. Po baj me diit, se neser mrama qyteti kaa per të dalë nen administracjon të Sundit të Malit të Zii⁸¹”, ndërkohë që gjatë kuvendit që u mbajt me parinë e qytetit për këtë ngjarje, u bë shamatë e madhe.

80 *Kalendari Vjetar*, 1914 f. 9.

81 Po aty, f. 13.

Esat Pasha u bënte të qartë se “mungesa e ushqimeve e shterngote me ju bâa tesliim Malit të Zi”⁸², dhe fajëson për këtë turqit, pasi shkruanin numra ushtarësh ndryshe nga ata që vërtet vinin dhe kanë bërë hile te ushqimet. Hyrja e ushtrisë malazeze shtoi vjedhjet ditën e natën në qytet. Më 7 maj, kralj Nikolla ia lëshon Shkodrën Fuqive të Mëdha dhe më 12 maj mbasdite, erdhën ushtritë e pesë “Pushtedeve: T’ Inglizit, të Nëmces, t’Itales, të Frâncës e t’Alemanjes. Valii në Shkoder kje êmnue perftyruesi i Gjermanjes, Klitzing”⁸³. Ky moment shihet si premtues sidomos nga Italia e Nêmcja (Austria) që i ndihmuan Shkodrës në problemet e urisë e zisë së bukës dhe shihet me shpresë krijimi i një qeverije që “t’jeet per mâa të madhin lulzim të Fees katolike, qi âsht besimi i pjeses maa trimneshë e maa gjytetnike të këtii koom. Mret në Shqypnii asht Zêmra e Krishtit e cila qyysh me 9 qershuer në vjetë 1907 â kênë kuronue prej bariis të këtii gjytetit Emz. Pashko Guerinit”⁸⁴. Në vijim flitet për shpenzimet e luftrave të ndryshme në botë si dhe për koston e lartë që pati vendi ynë në këto vite të vështira. Vlerësohet mbështetja e Austrisë dhe Italisë, si aleatët e vetëm që nuk lanë shtetet e tjera ta “shqyenin” këtë vend.

Kalendari Vietar 1915 (Vepra Pijore N. 13, botuar në vitin 1914), nis me disa emra të “shpirtmdhajve” duke filluar me Pjetër Bogdanin e deri te Kostandin Kristoforidhi, Sami Frashëri e ndonjë tjetër që kanë dhënë ndihmesë “n’lamë t’letratyres”, në zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë: “qi âsht vegla mâa e forta e atdhetarizmit e shtylla mâa e para e komit!”.

Brenda këtij kalendari gjendet edhe vepra letrare me titull “Federiku” e përkthyer nga Nikoll Kimza, e cila trajtohet si njësi më vete si *Vepra Pijore* N. 15. Pjesa e parë e tregimit fillon me “*Nji oroe e nevojshe*” mbi një plagë të shoqërisë së asaj kohe, “botimi edhë t’ëndunit i padaa i librave t’kqii” rrjedhimet e të cilëve kanë “me thaa n’zêmra t’popullit bîmen e virytit, me fikë vetedien, me jau hjekë t’maren nierzve...”⁸⁵, duke vijuar me një këshillë për prindërit që të kujdesen për fëmijët e mos ia largojnë sytë pse “shum, mâa t’hollë e torlarë ... janë mashtrue e rrëjtë fort keqas prej kndimesh t’rrezikshme”. Përmes kësaj *oroeje*, theksohet edhe qëllimi që në fillesa e në vazhdim i shoqatës së *Veprës Pijore*, pasi këto libra “t’kqii” siç po quhen edhe “feen e mrapshton ... e m’tjetren ânë shtriin nji perde t’errët mii atò t’mira t’panjehtuna qi prej sajë i kan rrjedhë e i rrjedhin shoqnies s’njerzve”⁸⁶.

82 Po aty, f. 12.

83 Po aty, f. 17.

84 Po aty, f. 17-18.

85 *Kalendari Vietar*, 1915, f. 32.

86 *Vepra Pijore*, nr. 15, Federiku, e dyta dorë, Shtyp. e Zojës s’Paperlyeme, Shkoder, 1915, f. 3.

Diçka nga kjo histori: djaloshi Federik, blen një libër “të keq”, fshehurazi prindërve me paratë e shitjes së një petku. Nga ai moment ai përpiket të mos bjerë në sy që ato pak para (15 solda) i kishte harxhuar për të blerë librin, dhe e lexon atë në fshehtësi. Çdo gjë që ai libër i “mëson”, e largon nga ajo që njihnte, pëlqente e shijonte deri atë kohë. “Veset i paraqiten t’lulzueshme e t’ëndshme, e virtytet i neveriten fare; edhe detyrat maa shëjte e t’vertetat e fees maa t’shugurueme i njehë per prralla t’moçme e jau sjell shpinen t’gjithave”⁸⁷. Ky “besim” i ri në të shijuarit e jetës, e shtynte gjithmonë drejt atyre librave “m’u dhanë edhe maa nder lezetë e vese t’mrapshita”. Dhënë pas instikteve e shijeve të tilla, babai i Federikut kërkon ndihmën e meshtarit për ta kthyer djaln në rrugën e drejtë, pasi përditë e më fort ai i ishte larguar punës e më pas s’do të kishte më fuqi e vullnet “me iu shtruar” asaj. Nuk dëgjoi asnjë, nuk iu bind askujt dhe e tërë ajo familje u fik prej hidhërimit dhe varfërisë. Varri i familjes kishte një gur me këto rreshta:

“Ktû pushojn eshtnat e një shpiis unji
Qi raa e kje fikun do librash t’kqii!!...”⁸⁸

Njeriu në jetë duhet të ruhet nga “gërbula”; e keqja si sëmundje kërkon që të shërohem, por e keqja si dije na kërkon mbi të gjitha të shpëtohem.

Në fund të kalendarit gjendet një përkthim nga italishtja “Framasunia per fushë” (La Massoneria in piazza), shkruar nga Rocca d’Adria drejtor i fletores “Il Mulo”. Ky *kallxim* historik bëhet me qëllim “t’ja çilin sytë shumkuej sidomos tësh qi fara e zezë e Masûnies vjen tuj mjellun edhe neper Shqypnii...”. Në të jepen të dhëna mbi mënyrën e organizimit, takimeve apo dhe shenjave, të veçantave të tyre misterioze, material i shoqëruar me vizatime shpjeguese.

Kalendari Vietar 1916, (Vepra Pijore N. 18, botim i vitit 1915), është më i pasur me materiale, që nga poezi, portrete për figura historike (Mark Boçari, Napoleoni I) apo figura të njohura në kontributin e tyre tek Urdhri Jezuit (rregulltari polak Vladimir Ledòchowski, Emz. Jakë Serreqi, Emz. Prënd Bianki, Emz. Lazer Mjedja, Emz. Prënd Dochi, Emz. Bernardin Shllaku, Emz. Luigj Bumçi, Emz. Gjergj Koleci) shoqëruar edhe me fotografi, për t’i prezantuar më mirë personat e përmendur.

Në faqen 38 të Kalendarit gjendet një përkthim nga gjermanishtja i Dom Lazer Shantojës⁸⁹, një poezi me titull *I Burgosuni e Flutra*, e poetit polak Jankowski, një nga mësuesit e Carit të Rusisë Aleksandrit II.

87 Po aty, f. 38.

88 Po aty, f. 43.

89 Prezantohet në këtë kalendar si një zë i ri, i cili do të vijojë me përkthime në disa numra të Veprës Pijore, materiale që gjenden edhe tek: L. Shantoja, Vepra, Botime Françeskane, Shkodër 2005.

Kalendari Vietar 1917 (Vepra Pijore, N. 19, botim i vitit 1916), për nder të përvjetorit të vdekjes së Skënderbeut⁹⁰, publikon një dramë me titullin “SKANDERBEGU JOSË T’LIRUEMIT PREJ ZGIEDHES S’TURKUT” e shfaqur “tesh 3 vjet prej djelmoçave t’Kolegjes s’Sh’ Françesk Saverit”⁹¹ dhe me një shënim sqarues mbi myslimanët apo turqit që banonin në Shkodër: “Turqve t’Shkoders e t’Shqypnis mos t’ju jesisin hatri për do fjalë që fliten në ket dramë kundra Sulltan Muratit II e kundra Turqve t’atyne ditve, që kah gjaku e gjuha e komi s’kam ç’bajn me Mislmanët e Shqypniis. Skanderbegu e Shqyphtarët ishin at botë krejt t’kshtënë, e prandej nuk mund t’flitshin ndryshej...”⁹². Drama është me pesë akte dhe shoqërohet edhe me foto të heroit dhe foto të armës së tij në Vjenë.

Kalendari Vietar 1918 (Vepra Pijore, N. 21, botim i vitit 1917) sjell një rubrikë të re, “Kronologjia e do t’ndollunave t’soçme n’Shqypniis” (1912-1915), e cila nis me rrugëtimin e vështirë të vendit tonë për krijimin e shtetit shqiptar, duke theksuar meritën e qeverisë së I. Qemalit e cila “kjë si kjë, e mrapa bânë edhe disaa gabime, por ata nierz patne meritimin t’parët me i paraqitë Europës një qeveri shqiptare, m’u pelqye prej sajë, e me ngrehë n’breg t’Adriatikut at flamur t’dishruem tash saa vjet”⁹³.

Të dhënat e detajuara të këtyre momenteve, ndalen te mbështetja e austro-hungarezëve përballë malazezëve që duan të mos e lëshojnë Shkodrën. Detajet jepen në çdo datë të rëndësishme duke përsëritur edhe ndonjë material të përcjellë në kalendarët e mëparshëm, si p.sh. dorëzimin e Shkodrës në duart e malazezëve nga gjeneral Esadi, më 23 prill 1913 dhe vijojnë ngjarjet deri në krijimin e qeverisë së Esad Pashës, e cila solli hasmëri ndërmjet toskëve e gegëve duke e karakterizuar këtë qeveri “për propaganda fanatike e fetare që axhentat e ksajë bâshin ndeper katunde e malcina”⁹⁴. Ngjarjet përcillen deri në ardhjen e Princ Vidit, krijimit të qeverisë së tij me kryeministër Turhan Permetin e deri në vitin 1916. Kalendari mbyllet në janar të vitit 1916, me luftën e austro-hungarezëve kundër Malit të Zi, ku theksohet sesi ushtria e Perandorit “dlihte prej sllavizmit marë deri n’breg t’Vojuses”; vëllimi mbyllet me sqarimin se është bërë aq sa ishte mundësia e në mos “ndo maa mirë tjeterkush kaa për t’a diftue mun një tjetër vjetë”⁹⁵.

90 Këtu shënohet si datë e vdekjes së tij, 17 janar 1467: “...masi pat lngue për disaa kohë, ulte kryet e diste me 17 Kallnduer 1467, e praa bash tash 450 vjet” (*Kalendari Vietar*, 1917, f. 25).

91 Po aty, f. 26.

92 Po aty, f. 26.

93 *Kalendari Vietar*, 1918, f. 18.

94 Po aty, f. 29.

95 *Kalendari Vietar*, 1918, f. 53

Në vijim gjendet një portret i Donikës së Skënderbeut, për t'u njohur e respektuar figura e saj, po aq sa dhe heroj ynë. Sipas kalendarit, Gjergji prej saj pati "nji djalë (Gjonin) e nji vajzë (Vojsavën)"⁹⁶.

Nga Kolë Thaçi me shënimin në fund *Shkodrë, me 25 Mâaj 1917*⁹⁷, sillet një himn me titull "Mbi ndertesë të Kishës brî Rozafet", ku shpalosen vlerat historike të qytetit, trishtimi për gjendjen e tij dhe adhurimi për të: "Arsye kan shekujt ktû m'u mbledhë, o të bardha/ Zana, per me Ju ndie, mbasi ligjë të reja/ Së parit të vëndueme po pertrijn mbî të vjetrin/ Themeel njat Monument qi i naltë do të ngelin,/ Nder saa mote qi Dielli të lamparisin,/ Per nâam t'Atdheut.⁹⁸", për Shkodren me mure të larta që i quan *ligjeratë kreshnike*, mure e shkëmbinj që gjithnjë bërtasin për ndihmë të Shën Mërisë me thirrjen për ndihmë: "Kthe o Nanë e dashtun, nder kto lagje të hershme' Qi Shkodra t'i kaa ruejt, ktheu nder kto suka? Qi gjak Arbnorit per saa mot kan pii." Luten për një qytet që po shkatërrohet nga lufta e të huajve *me sÿy të vjerrun* dhe foshnjët e njoma "tuej ja lypë krahnorit amtaar ushqimin me nji buzë t'irnueme", panë nënat me sytë nga qielli për të gjetur ushqim. Këto ledhe, këto shkëmbinj, këto pîrgje "të shugurueme në themel e dijn saa kobe/ Të mndershme rânduene mbî Gjytet se Moti/ Tregimet e ktii dheë në kët vis i dhên". Legjendën e Rozafës, mitologjinë e zanave, besimin e Marisë, historinë e emrave të të rënëve, autori i lidh e i bën bashkë në këtë himn. Zanat i luten Virgjërës ("Luten, o Virgjin, qi prej s'eprit Zanat/ neper rriba t'ajriës janë tuej m'a prûe") për të ndihmuar këtë vend që i sharroi djemtë nëpër luftra ku "fisin t'em sundimit/ Të Rozafës natyra per dyzer qindvjeta/ Ja shtroj...", të cilët kanë dhënë jetën ndër shekuj e sot janë të harruar pa një gur kujtese me një *falenderje të rrëjshme* me një *krahanuer krejt akullue* për kujtim të tyre. Himni mbyllet në fund me shpresën se "Tu kÿ Tempull bashku, motet e vrânta/ Kaa me i permëndë tu' u shtângë, e Ftyra e së Lûmes/ Kaa m'e shkrië tu kÿ vis ndejë si motit/ Gurren e hirit qi të shperblejn ket dheë.", si një tempull dashurie në emër të Marisë, tempull i ruajtur në amshim për të ndihur atdheun. Gjuha e pasur, e rrjedhshme, e bukur e himnit gati si një prozë, ku nuk respektohen rregulla të vargëzimit klasik, është karakteristikë e himnit të kishës së orientit, lloj shkrimi që vijoi të përdorej edhe pas kohës së Efraimit⁹⁹. Himni është i shoqëruar me foto të klerikëve (Arq. i Durrësit Prend Bianki, Arq. i Shkupit Lazer Mjeda, Ipeshk. i Pultit Bernardin Shllaku). Në faqen 78 jepen të dhëna mbi shytin (turren) e derës së Kastriotëve, marrë në varrin e Kostandin Kastriotit, nipit të Skënderbeut i cili vdiq në Itali në vitin 1500 si Ipeshkv i qytetit të Isernias (Exernia), një foto që gjendet sipas kalendarit, në librin e Zef

96 Po aty, f. 59.

97 Po aty, f. 77.

98 Po aty, f. 61

99 Nisur nga shkrimet e Sh. Efraimit të Sirisë.

Skiroït “Gli Albanesi e la Questione Balcanica”, pag. 501. “Ky vorr gjindet e mund të shifet edhe sot n’nji rruginë te sakristia e Kishës Santa Maria la Nova in Napoli.” Në këtë material jepet përshkrimi nga vetë Donika, gjyshja e Ipeshkvit që del edhe si dokument historik që ajo (Donika) 33 vjet pas vdekjes së Skënderbeut, ishte ende gjallë.¹⁰⁰

Kalendari i Vietës 1919 (Vepra Pijore, N. 23, botim i vitit 1918), sjell një shkrim me titullin “*Sot e sot nji qind vjet*” për Luftën I Botërore e cila sipas artikullit paraqet analogji me luftën e Napoleon Bonapartit. Ky shkrim kërkon të analizojë situatën e vendit, si një mësim që historia bën, se si të ecë përpara në liri e me cilët aleatë të lidhet për të jetuar “me nderë jo n’Azi a n’Afrikë por n’zëmer t’Europës” e për ta parë vendin të ecë në “rrugen e shndritshme t’gjiytetnimit e t’perparimit t’vertetë”¹⁰¹. Në këtë kalendar ka një përshkrim të jetës e veprës së Isa Boletinit në përkujtim të 3-vjetorit të vdekjes së tij, bashkë me djalin Tafilin, vrarë nga malazezët. Si një njeri “zëmrak, luftarë trim e me karakter t’ngulët” paraqitet edhe kapidan i vërtetë që “dite me vûe rregull e dishiplinë nder ato Shqyptarë t’vet qi maa t’shumen janë msuemun mos me i ndigjue kuej”. Interes shfaq edhe shkrimi “Njerz t’ndritshem... xânsa t’kqij” ku flitet për figura të njohura botërore të fushave të ndryshme që nuk kanë shkëlqyer në shkollë dhe mësuesit e prindërit i ndëshkonin rreptësisht për t’i drejtuar në rrugën që mendonin se ishte e drejtë me ecë. Të tillë janë: Galileo, Njuton, Mikelanxhelo etj. Gjenialiteti i njeriut del në pah, edhe pse shkolla nuk arrin ta vërë në dukje. Pastaj ndeshim shkrimin me titull “Prej Krujet e deri m’Elbasan” ku flitet për kalanë e Krujës, Petrelës e deri në fushë të Elbasanit, sipas të cilit i ka dhënë emrin Albanisë mbarë: “Disaa dheshkruesa t’hershem na seguojnë se Albanopolis gjindte 40 kilometra lerg prej Lezhjet, asë shi aty kû âsht sot Elbasani...”¹⁰² Shkrimi ndalet dhe te besimi katolik në këto vise nga 1166 e deri në 1636, të cilët kishin edhe ipeshkvin e vet gjithmonë katolik, por lufrat dhe ndryshimi i fesë për “qëllime të shekullit” i ndau dhe hyri përçarja ndër ta “tuj harrue Shqypniin e tuj pasë zëmren maa fort n’tokë t’Slavit e t’Grekut...”¹⁰³

Kalendari i Vietës 1920 (Vepra Pijore N. 26, botim i vitit 1919), ka fjalën e Ndoc Çobës, bashkë me disa të tjerë mbajtur më 28 Nëntor 1918 “n’t’bukrin balkue t’Perlimtares s’Shkodres”. Ndër të tjera, gjatë fjalës së tij z. Çoba thotë: “Sot Shqypnija âsht e njoftun prej Fuqiive t’Mdhaja t’Entantes sikursë nji Shtet n’vedi”, por ama “Shqyptarët, me t’prûemun t’onë t’mirë

100 Po aty, f. 79.

101 *Kalendari Vietar*, 1919, f. 20.

102 Po aty, f. 39.

103 Po aty, f. 40.

e t'nierziishe e me urtii t'onen, do t'diftohena t'dêjë per vetqeverimin e Shqypniis, sidomos tuj kûndrue se do kome fqine orvaten nder t'gjitha mndyrët per me na paraqitë n'faqe t'botës s'gjetetnueme sikursë një popull i eger, një popull i shkalitun, një popull qi gjindet n'anmiqsii ndermjet t'shoqi-shojt"¹⁰⁴. Theksohet nga folësi rëndësia e bashkimit të të gjitha pjesëve të Shqipërisë ku ndiqen zakonet e popullit shqiptar nën flamurin e tij, nën një qeveri shqiptare. Shkodrën, si qyteti më i bukur e më i madh, më i përmenduri në histori kombëtare, e mendon të zgjidhet e të njihet si kryeqyteti i Shqipërisë.

Kalendari i Vietës 1921 (Vepra Pijore N. 27, 1920), si shkrim të parë ka "Mas një vjetit" si analizë e Konferencës së Parisit e cila nuk ia solli "Europës njat pagjë të drejtë e qindruese e njat fatbardhësi qi lypte e pritte zëmra e çë do nierit t'urtë"¹⁰⁵. Këtu ndalet te padrejtësitë në ndarjen e tokave që u ishin bërë shumë shteteve, po sidomos Shqipërisë që ka "mâ se një milion shqyphtarësh neper Greqi e neper Jugosllavi" me frikën se a do të njihet Shqipëria si komb që i gëzon tërë të drejtat e saj. Thirrja e fundit e shkrimit është "Shqypnija nuk mundet me dekë!". Në faqen 33 të kalendarit është sjellë një dokument i vitit 1610, gjetur në bibliotekën e Vatikanit, i shkruar nga Imz. Nicolò Mechaisci (Ipeshkv i dioqezës Stefanense e Bendense gjatë viteve 1592 -1620). Në hyrje të dokumentit theksohet nga ana e redaksisë, se materiali nuk ka qëllim "me njallë neper Shqypni ndoj kryengritje, se koha e ktyne sendeve ká kalue" e siç nënvizohet do t'i shtrohen qeverisë që i sundon, por e sjellin dokumentin "per me njoftë se si u mendojshin Shqyphtarët me shkundë zgjedhen e Turkis, qi ner ato kohna jau shtë mneren Europes marë". Titulli i dokumentit është "Kola ipeshkv Stefanез i difton papës Palit të Pëstë mnyren se si mund të librohet kshtënimi i Shqypnijas e i Maqedonijas", i shkruar në Romë më 15 korrik 1610, ku kërkohej ndihmë për të hequr qafe zgjedhën që u rëndonte, ndihmë e cila nuk erdhi, siç dëshmohet "pse nuk i dukej se mujte nder ato ditë me i çilë Turkis luftë me dobi; e kshu tek e mramja si Shqypnija si Maqedonija metne me Stambollë deri në luftë balkanike të ktyne vjetve të mrame".

Kalendari i Vjetës 1922 (Vepra Pijore N. 29, 1921), në shkrimin mbi historinë, sjell pemën gjenealogjike të familjes së Kastriotëve, që nga stërgjyshi i Skënderbeut, Kostantini e deri te stërnipi i Skënderbeut, Ferdinandi. Stërnipi Ferdinand dhe pse pati 6 djem, asnjëri nga ata nuk trashëgoi djem të tjerë dhe dera e Kastriotëve nga ana e meshkujve mbaroi. Më tej ndeshim në shkrimin: "Lexò... e gjykò" (f. 26-32), ku flitet për Esad Pashë Toptanin, tërë rrugën e tij politike, prejardhjen e tij, tradhëtitë e

104 *Kalendari Vietar*, 1920, f. 35.

105 *Kalendari Vietar*, 1921, f. 17.

deri në vrasjen e tij. Ishte vetë Esadi që udhëhoqi delegacionin shqiptar për të marrë Princ Vidin dhe deklaroi para popullit të Durrësit “se ditë më të gzueshme se kishte pá komi shqyptár” ndërkohë që më 19 maj 1914 “çoj peshë katundarët e tokve të veta për me perzânë prej Shqypnijet at Mbret”¹⁰⁶. Në këtë portret që i bëhet Esat Pashës, ndër të tjera thuhet: “kje një nieri që guxoj me luejt, si mica me mînin, me fatin t’ynë, e që shkaktoj një varg ndollinash të randa e krejt të zeza që prej asajë ditë që u krijue një Shqypni e lîr”. Siç është dhënë edhe në Kalendarin e 1918-ës, në një mbledhje “të mshehtë që u bâ në Barbullush me serb-malazez e me Esadin, ky ja u shiti Shkodren për një tre milûj frank. E shi n’at ditë kuer u largue ushtria e Serbjanve e u blokue bregu i Malit Zî prej Europës, e malazezt bâheshin gadi për me kthye në Podgoricë, Esadi me dorë të vet nenshkrujte dorzimin e Shkodrës” dhe sipas shkrimit, qëllimi i tij ishte të bëhej mbret në Shqipërinë e Mesme me ndihmën e serbëve e të rusëve, duke ia lëshuar Shkodrën Malit të Zi e Toskërinë Greqisë. Shkrimi, vdekjen dhe fundin e Esad Toptanit, e përmbyll me fjalët: “Lakmija e tepershme e parevet, madhshtija, zmira e egoizmi janë e zeza e gjithkuej, e janë një lëngatë që fatzezishtë e kena trashigje prej shkollët të ktyne 450 vjetve”.

Kalendari i Vjetës 1923 (Vepra Pijore N. 30, 1922), na sjell një dokument të vitit 1668 të Atë Gjon De Camillis i cili bashkë me disa misionarë të Urdhërit të Shenjtë të Sh. Vasilit, kishin qenë ndër malet e fshatrat e Himarës ndër shqiptarë katolikë. Këtë dokument ia dërgon nga Drimadha rektorit të Kolegjit greko-katolik të Romës. Dokumenti, i shkruar në italisht, gjendet edhe sot në atë kolegji, firmosur më datë 18 qershor 1668 dhe “dishmon jo veç se që farë besimit e që farë nduresh ishin, por pernjiherë edhe na pershkruen gjëjen e mjerë t’atynë bashkatdhetarve t’onë”¹⁰⁷, skamjen e tejskajshme. Për trimërinë e tyre thuhet se: “Himarasi janë burra të fortë e të prirun kah lufta [...] e me gjith boten, si me thanë, janë anmiq...” por të thjeshtë fort dhe besnikë. Gjithashtu autori i letrës tregon edhe vështirësitë e jetesës së tij si misionar në këtë vend, si dhe kërkesën e himariotëve për të hapur një shkollë, e ndaluar kjo prej despotit grek. Sipas shënimit¹⁰⁸, në vitin 1670, pak kohë përpara, misionari De Camillis, kishte shkuar si mësues i shkollës në Himarë, pasi ishte mbyllur edhe shkolla shqipe katolike në Drimadhe¹⁰⁹.

Një shkrim interesant në kalendar është gjithashtu “Leter çarkore e Luciferit, besnikve të vet në të tanë boten e gjytetnueme më 1 Majë 1914”,

106 *Kalendari Vietar*, 1922, f. 26.

107 *Kalendari Vietar*, 1923, f. 35.

108 Po aty, 1923, f. 42.

109 Po aty, f. 42, thuhet se këtë të dhënë e gjen në Arkivat e Kolegjes greke të Romës, t. I f. 268-269.

një letër ironike që u drejtohet të gjithë njerëzve që i bashkohen të keqes pa frikë dhe bëhen bashkë në “Thesin e prejeve”, siç quhet në letër.

Kalendari 1924 (pa shënimin *i vjetës*, Vepra Pijore N. 33, 1923), fillon me një shkrim për konkursin e zhvilluar nga Ministria e Arsimit, në qershor “të motit të kaluem” për vendosjen e një himni kombëtar. Sipas shkrimit, 12 vetë i janë përgjigjur kësaj thirrjeje dhe vetëm dy prej tyre u shpallën fitues: himni i shkruar nga Ernest Koliqi dhe Kristo Floqi.

Me titullin “Per histori të Shqypnis”, prej librit të Nikoll Mattia Rossi-t, botuar në Bolonja të Italisë në 1787, është kopjuar një material që i kushtohet Kontit Ndrekë Ejllori ose Ndrekë Radovani, (drejtor i Postës spanjolle në Ankona për atë kohë), familje e nderuar, e njohur para e pas kohës së Skënderbeut, provuar si pasardhës i kont Ndreka Paranik e Vojvodë i Drishtit, ati i Palit dhe Pjetrit. Shumë lajme e njoftime të çmueshme “flasim per derë t’permendune t’Ejllorve edhe do historjakë tjerë të Venedikut kuer bín çashtjet e Shqypnis, si edhe ata qi shkruene Jetën e Gjergj Kastriotit...”.¹¹⁰ Për Pal e Pjetër Engjëllin thuhet se: “Virtyti e atdhetarija, per të cilat i duel aq zâni Kont Ndrekës, duket se kje trashigue krejt prej dy të birve të t’i” dhe kjo i nxiti dhe ata “per m’u rritë në lumni e m’u bâ edhe ata zâmdhaj e të permëndun. Kta kjenë Emzot Pali i Ejllorve, nji herë Ipeshkev i Drishtit, e mandej Argjipeshkev i Durrësit, prelat i dâm në shêj per pershipirtni, per dituni e per nji mende të hollë në perdorim të çashtjeve të nelta e má me randsi; e Pjetri i Ejllorve, nieri i mëçem, trim, e fort i rrahun në dije luftarake, e prandej i dashtun si prej Skanderbegut ashtu edhe prej Republikës së Venedikut”.¹¹¹ Në shkrim flitet gjerë e gjatë mbi dy djemtë e Ndrekës, Palin dhe Pjetrin deri në kohën e rënies së vendit në duart e tiranisë otomane, pas Rrethimit të Dytë të Shkodrës. Për t’i shpëtuar tiranisë, për të shpëtuar besimin, shqiptarët u shpërndanë në Dalmaci e Napoli, ndërsa shtëpia e Ejllorve apo Radovanëve, u shpërngul në Shirokë.¹¹² Materiali historik i familjes së Ejllorve apo Radovanëve (janë të dy mbiemra të të njëjtës familje, pasi ky i fundit është përdorur gati gjithmonë këto 200 vjetët e fundit), përcjell rrugëtimin e kësaj familjeje të përkushtuar, me një bujari të provuar e të pandërprerë, për të cilën drejtori i postës në Ankona, Ndrekë Ejllori duhet të ndihet krenar për origjinën e të parëve të tij në zë si kreshnikë të fesë e të atdheut.

Problemet e Shqipërisë e të shqiptarëve vihen në dukje, në një poezi si dialog imagjinar midis të vjetrës e të resë; “dialogojnë” viti 1923 me vitin 1924. Rreziku më i madh i shprehur aty është ndikimi i socializmit, komunizmit dhe “framashût” (masonët). Urimet në këtë “bisedë” janë që

110 *Kalendari Vietar*, 1924, f. 26.

111 Po aty, f. 30.

112 Po aty, f. 35.

ky vend të ketë njerëz me ndërgjegje që dinë t'u qëndrojnë trazimeve që ndodhin udhës së jetës, t'i thërrasin mendjes e të pendohen për kobet që i sjellin vetes e të tjerëve e vendi të mos ketë më vaj, zi, lufta e mjerim e viti i ri "me i lajmue nierzimit dý fjalë të bekueme: "Pagj' e Lumní"!". Siç njofton në fund të kalendarit, *tash Vepra Pijore ka mbushur 16 vjet të themelimit të saj*.

Kalendari i Vjetës 1925, (Vepra Pijore N. 34, 1924), karakterizohet prej një toni patriotik, që nga poezitë "Europës marë", "Atdheut", deri te shkrimi për jetën e B. Currit. Kalendari përcjell me një devotshmëri dokumente shqipe, si ai mbi *Rrethimin e Parë të Shkodrës*, pasi për të "dihet më pak se për të dytin i cili është përcjellë në libra të ndryshëm". Materiali për Rrethimin e Parë, është shkruar në latinisht nga Gjergj Merula, përkthyer nga Dom Ndre Zadëja. Ky material, origjinali i zbuluar prej Gjon Çobës, gjendet në bibliotekën e Venedikut; vjen si një letër që autori ia dërgon dy miqve të tij me titullin "Lufta shkodrane"¹¹³ dhe me nënshkrimin *Venedik, 10 shtator 1474*.

Kalendari i Vjetës 1926 (Vepra Pijore N. 35, botim i vitit 1925), ka një material studimor të Nikollë Gazullit me titull: "Hulumtime ilirjane-shqyptare" – Sh. Niçeta a Sh. Nika i Remezanës". Remeziana e moçme është një vend një orë larg Nishit dhe "në ket gjytet doli në zá Sh. Nika, e me të u shndrit mâ fort ungjilli nder ata popuj, e êmni Remezanës nuk u harrue pse kje si me thanë djepi i nierit të madh", për të cilin është folur në këtë shkrim që ktheu në fenë kristiane Besajt dhe Thrakët. Shën Niçeta apo Shën Nika njihet dhe si autori i këngës "Te Deum" që këndohet edhe sot ndër funksione fetare. Në 20 mars, Kisha Katolike feston ditën e tij. Aty referohen fakte historike tashmë të njohura për ne, por me tepër rëndësi për ato vite. Si thuhet edhe në krye të shkrimit, "para se me folë mbi Shën Niçeten âsht mirë qi t'i paravêm në ket shkrim disâ njoftime mbî fise ilire e permbî krishtenim të parë në ket dhé... prej kufinit juguer të Norikut e mjé në sukalene (brigje) të Murr-detit (Deti i zî) ase Ballkani i soçem marë per posë Greqijet, gjith kjo trevë ishte e banueme para Krishtit prej viseve të laryshta të njaj lemije a komit. Fiset ilire: Dake, Thrake, Makedone e Toske, e zotnuene ket trevë per mija vjetsh e kaluene tuj lanë si ferkêm të gjallë popullin Shqyptar"¹¹⁴. Këtë dokumentim të ekzistencës së paraardhësve, e gjen si "nji dishmí të pathyeshme të kalimit të vet nder êmna lumdash, malesh e qytetesh" dhe me "emna dheshkrojet të shum vendeve kû banon lemija e soçme e jona" që dijetarët e cenët e pa paragjykime munden "me i vue caqet ku shkелne e ku banuene fiset e ndryshata t'etenve t'onë". Në shkrim, lidhur me përhapjen e krishtëritimit, përmend fjalët e Sh. Palit në

113 *Kalendari Vietar*, 1925, f. 51-70.

114 *Kalendari Vietar*, 1926, f. 20.

Letrën dërguar romakëve se e kishte përhapë ungjillin *usque ad Illyricum* – deri n’Iliri, dhe se ungjillizimi i fiseve të ndryshme ilire “ngiati shumë e shumë vjet, e sikurse msojmë prej historijet e prej jetës së Niçetës, më sa krishtenimi kishte ngulë rrajë gjithkund, ishin prap aso fisesh, sikursë Besajt e Thrakët, qi ende kishin mbetë gjindtarë ase idhujtarë.”¹¹⁵ Autori fillon të tregojë për jetën e *Shën Niçetës* ku sipas një letre dërguar ipeshkvinjve katolikë (aty përmend Niken e Remezjanës), në vitin 366 ishte ipeshkëv i njohur në Iliri.

Në rubrikën “Per histori të Shqypnis – dokument 1”, sillen emrat e disa zotërinjve shqiptarë, të nxjerrë prej shkrimeve origjinale që ruhen në *Arkiv të Magistratit të Madh t’ati Princit aq të xët kah feja si kje Don Angelo Flavio Comneno, Mjeshtër i Madh i Urdhërit Perandorak të Kreshnikëve Kostantinian të Shëjtit Sh. Gjergj*, nga viti 1419-1574. Dokumenti i vitit 1419 i takon Imz. Pal Ejllit, Arqipeshkv i Durrësit, i cili përmendet në një letër që i shkroi Kristofor Moro-ja, Dukë i Venedikut. Letra flet për “t’avitun të Turqve nën Krue, e pergëzohet per të nisun të tyne”¹¹⁶. Po në rubrikën “Per histori të Shqypnis – dokument 2”, jepen disa shtëpi të moçme të Kamsejve të Shkodrës ose më mirë të Drishtit, prej një letre të moçme të tetor 1709-ës, gjetur nga Imz. Ernest Cozzi, që flet për Dukë Angeli-n, nga dera fort fisnike e Ejllorve të Drishtit, për të cilët është folur në kalendarin e vitit 1924 (shih f. 26-45)¹¹⁷.

Kalendari i Vjetës 1927 (Vepra Pijore N. 36, 1926), te rubrika “Per Histori të Shqypnis, nga libri i ndollinave qi botoj Anton Koberger, Norimbergë në vjetë 1493”, sqarohet se ky libër i vjetër që flet për punë të Shqipërisë, është gjetur në Padovë, në bibliotekën e Pensionatit “Antonianum”. Dokumenti i përkthyer nga latinishtja është ky¹¹⁸:

Njajo qi sot quhet Shqypnie këqyrë kah prendimi, dikur pat këne pjesë e Maqedonis; kena mërritë me dietë per fill se në gjí të sajë Durrçi e Apolonia kishin këne gjytete të permenduna në kohë të vjetra. Giuha e komit nuk njifet as prej Grekve, as prej Ilirve. Kujtojmë se ky ród nierzish ka aedhë motit prej Albanís qi, si thonë, áisht afer Kolkides në Shitje t’Azís: kështû shpesh boena e komeve barbare muer provinçet e Greçís e t’Italís. Në ket dhé kje i fortë Kamuza, i cilli, i lém prej prindve të krishtëne, por i ligishtë per fé katolike, kaloj në fé të Muhametit. Por sikursë mende-letas e la Krishtin, ashtû udobisht perbuzi punët e Muhametit, pse këthej në ligjë të parve; sa do qi ja pat majtë besen asnjënës, gjithnji desht mâ mirë me dekë i krishtëne se turk. Pak gjâ mas kerdís të Stamollës diq lngatet. Trashigimin e tí e muer Gjergj Skanderbegu,

¹¹⁵ Po aty, f. 21.

¹¹⁶ Po aty, f. 44, letër që daton 26 korrik 1419.

¹¹⁷ Po aty, f. 55.

¹¹⁸ *Kalendari Vietar*, 1927, f. 25 (shkrimi jepet në dy kolona latinisht – shqip).

deret fisnike, i cilli gadi të tanë jeten e vet e shkrini nder armë tuj luftue per fé të Krishtit. Shum e të mdhá aradhe turqish mujti edhë shqymí, e vetun, të thuesh, e majti n'Unjill të Krishtit at dhé, sado qi sot, i mësyem prej shpatës s'anmikut, po thonë se â lânë shkret gadi krejt. Mret Alfonsi çoj shpesh ushtarë në Shqypní e i duel zot gjytetit të Krues të pushtuem prej turqve. Tuj kênë se një nip vllaut i Skanderbegut, i cilli i ndimote ânës së turkut, orvatej m'e qitë në kurthë axhen e vet, kje xânë prej kêtí e çue tu Alfonsi e shtí në burg. Edhe Kalisti, Papa i Romës i dergoj Skanderbegut ndimë të hollash jo të leta.

Vlona në Shqypní âsht një gjytet jo i madh, por në një limâ prej të cillit kalimi n'Italí âsht fort i shkurtë; ket gjytet, mâ i pari nder turq e pushtoj Bajazeti. Kúr bâni kryengrítje, Murati e shtíni prep në dorë. Nuk dí se ç'farë të zezet matet me i bâ Italís.

Në vijim, kalendari sjell të përkthyer nga italishtja tre kapitujt e parë të veprës tepër të njohur të A. Manzoni, "Të fejuemët". Përkthimi është i ilustruar edhe me disa vizatime, që e bëjnë atë më tërheqës. Në hyrje të kapitujve, përcillet edhe jeta e autorit bashkë me analizën e veprës për ta bërë disi më të qartë për lexuesin e asaj kohe dhe theksohet se:

"Masa e ré e jona, qi nder shkrime s'lakmon kurrjá mâ fort se romanxin e dashtnís, ka me gjetë n'Aleksander Manzoni-n mâ të bukrin e mâ të pastrin romanz dashtniet, e ka per t'a kendue jo veç me gëzim e me kënaqë, e pa e zhytë menden e zëmren e vet zamake; por edhé me dobí të madhe fort, pse ka me mujtë me xânë prej tí sa mësimë të shëndoshta moralit e Filozofín e jetës. Këjo arsye kje qi e shtýni drejtimin e Vepers Pijore m'e mârrë mî vedi barren edhë të randë të kêtí perkëthimit"¹¹⁹.

Ky është botimi i fundit i kalendarëve të Vjetës.

Pamja grafike e kalendarit

Lidhur me anën grafike të kalendarit, ka një përmirësim të tij nga numri në numër, si nga pamje e kopertinës, nga fotot që vijnë duke u shtuar dhe nga përpunimet drejtshkrimore e tipografike të fjalëve. Nga kalendari i vitit 1913 e për disa numra rresht hiqet nga kopertina fjala *vietës* dhe shënohet thjesht *kalendar*. Po ashtu ndryshon edhe fjala *Vieti* në *Vjeti* e pastaj *Vjeta*. I pari kalendar, ka një kopertinë bardhë e zi me disa lule *kumone* e me dy dallëndyshe. Në kalendarët e tjerë sipas rëndësisë së ngjarjeve të vitit, ndryshon edhe kopertina si p.sh.: shqiponja dykrerëshe, profili i Skënderbeut, portreti i Zef Skiroit etj.

Shpesh, në faqen e fundit të kalendarit rreshtohen librat që gjenden në shtypshkronjën e "Zojës së Papërlyeme" apo edhe botime të të përkohëshmeve të tjera që rekomandohen për lexim letrar apo fetar.

(vijon)

119 *Kalendari Vietar*, 1927, f. 33.